

Ministri Tafaj duke biseduar në konferencën "Siguria e Fëmijëve në Internet"



Edukimi garanton lirinë më mirë se një ushtri e armatosur E. Everett

EDITORIAL

Kohë këshillimi për maturantët

Ministria e Arsimit dhe Shkencës po angazhohet së tepërmi në fazën e tanishme të këshillimit të karrierës, për vitin akademik 2011-2012, me qëllim që përcjellja e informacionit të jetë e plotë dhe e domosdoshme për maturantët e këtij viti dhe gjithkujt që dëshiron të ndjekë Shkollat e Larta brenda vendit.

Dihet tashmë, që prej pesë vitesh Institucioni i Maturës Shtetërore ka ardhur duke u forcuar, si në cilësi ashtu edhe në performimin e saj, në raport me institucionet e Arsimit të Lartë, por dhe me vetë maturantët. Për t'u ardhur në ndihmë maturantëve që dëshirojnë të vijojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Lartë brenda vendit, si dhe në kuadër të këshillimit të karrierës, po u vihet në dispozicion një informacion i plotë për t'u njohur me mundësitë e aplikimeve drejt universiteteve dhe ofertave të tyre.

Ky informacion është përditësuar gjithnjë e më mirë dhe cilësia e përzgjedhjeve prej maturantëve, duke ndjekur parimin "Meritë - Preferencë", ka qenë gjithnjë e më eficientë.

Por me gjithë këtë, jo rrallë në të kaluarën, madje edhe në Maturën e vitit të shkuar, pati raste përzgjedhesh për preferenca që nuk përputheshin me mundësitë dhe meritën e tyre të shkollimit dhe që ishin orientuar jo drejt në shërbimin që ofrojnë Shkollat tona të Larta.

Ajo që duhet të kihet kujdes, është mënyra e përzgjedhjes së programeve studimore, procedurat e të cilave duhet të jenë sa më korrekte, transparente dhe brenda mundësive dhe dëshirave të maturantit.

Pikërisht për këtë gjë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të verë në dispozicion të shkollave të vendit, në këtë hap të parë, informacion të plotë për Këshillimin e Karrierës. Fletëpalosjet dhe manualët, e mbushura me këto të dhëna të domosdoshme për maturantët, kanë filluar tashmë të jenë në dorën e tyre. Atje do të gjeni rrugët e mundshme të informacionit të plotë dhe adekuat që duhet të disponojë çdo maturant që kërkon të vijojë studimet e larta në një nga universitetet publike dhe jopublike të vendit.

Edhe vetë universitetet do jenë pranë gjimnazeve në këtë iniciativë, për të shpalosur ofertat e tyre ndaj studentëve të ardhshëm.

Në këtë numër, redaksia e revistës "Mësuesi", po boton tekstet e dy fletëpalosjeve që janë tashmë pranë DAR/ZA-ve dhe, në të ardhmen, do të botojë gjithçka që lidhet me Institucionin e Maturës Shtetërore dhe që është në dobi të nxënësve.

ARSIMI&REFORMA

Diskutimi
i Projektligjit
të Arsimit
Parauniversitar,
drejt fazës përmbyllëse




NGA XHAFER DOBRUSHI, KRYETAR I FSASH Statusi i mësuesit

një nga kolonat kryesore të projektligjit të ri

MËSUESI&NXËNËSI

Të mësuarit gjatë
gjithë jetës
një kontribut
i mundshëm
i universiteteve tona


Prof. as. dr. Abdulla BALLHYSA



SHKOLLA&KOMUNITETI

Globalizmi në
Arsimin e Lartë

Dhimitër BAKO/MASH



Në kërkim të shkollave të mira

Vjollca SPAHO

TRADITË&KULTURË

Me kujtimet e
shkollës "Kosova" në
prag të 7 Marsit

Nga Emine OKTROVA



Dëshirë, të jesh përsëri pranë nxënësve...
(Pak radhë për "Mësuesin e Popullit"
Fabri Doçi)

Nga: Prof.as.Dr. Murat GECAJ



<i>Përmasjtja:</i>	<i>faqe</i>
Si të zgjedhim shkollën e lartë?	2-3
Intervista e numrit	4
<i>Arsimi dhe reforma</i>	
Kurrikula e re e gjimnazit-nxënësit-shkolla	5
Projektligji i Arsimit Parauniversitar, drejt fazës përmbyllëse	6-9
<i>Mësuesi dhe nxënësi</i>	
Të mësuarit gjatë gjithë jetës një kontribut i mundshëm i universiteteve tona	10-11
Gjuha amtare, vlerë dhe detyrë për gjithsecilin	12-13
<i>Shkolla dhe Komuniteti</i>	
Globalizmi në Arsimin e Lartë	14-15
Reportazh nga dy shkolla të kryeqytetit	16-17
Punë më projekte	18
Mësimdhënia post-moderne	19
Në kërkim të shkollave të mira	20
Psiko dëshmi	21
<i>Traditë dhe kulturë</i>	
Me kujtimet e shkollës “Kosova” në prag të 8 Marsit	22-23
Njoftime	24
Udhëzime	26-28
Dëshirë të jesh përsëri pranë nxënësve	29
“Ambasadori i kombit tonë”	30
Në shkollën shqipe “Gjuha Jonë” në Çikago	31

Si të zgjedhim shkollën e lartë?

- Për maturantët -

Shkolla e lartë është një investim i madh për jetën. Bëni kujdes.

Çfarë duhet të dini që zgjedhja tuaj të jetë sa më e drejtë?

PËR SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE

1) Mbi programin e studimit

Programi i studimit duhet të përgatisë studentët për tregun e punës dhe për studime të mëtejshme. Nëse programi bën pjesë në profesionet e rregulluara, të diplomuarit, pas praktikës profesionale, i nënshtrohen provimit të shtetit, që zhvillohet jashtë shkollës së Lartë.

Profesionet e rregulluara janë: mjekësia, stomatologjia, farmacia, infermieri, mami, fizioterapi, mësuesia, arkitektura, veterinarja dhe inxhinieria.

Përpara zgjedhjes:

- Informohuni mbi programin e studimit.
- Pyesni sa studentë diplomohen në këtë program dhe sa prej tyre janë punësuar.
- Pyesni si zhvillohen provimet e lëndëve dhe si administrohen ato.
- Pyesni nëse kreditet (ECTS) që fitoni aty, janë të transferueshme brenda ose jashtë vendit.

2) Mbi profesoratin e shkollës

Shkolla e lartë duhet të ketë pedagogë të kualifikuar, me tituj “Master”, “Doktor”, “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”.

- Njihuni me pedagogët e moduleve dhe kualifikimin e tyre.
- Pyesni studentët aktualë nëse janë të kënaqur me pedagogët.
- Pyesni për tekstet mësimore që përdorin pedagogët, dhe për çmimet e teksteve.

3) Mbi përshtatshmërinë e mjediseve

- Vizitoni ambientet, laboratorët dhe informohuni për gjendjen aktuale të tyre; për orarin e bibliotekës dhe për lidhjen me internet.

- Interesohuni nëse shkolla ka konvikte dhe informohuni për gjendjen e tyre.

4) Mbi kujdesin ndaj studentëve

- Informohuni për zyrën e këshillimit të studentëve, për pedagogët kujdestarë dhe për këshillat studentore.

- Pyesni studentët aktualë nëse ata janë të kënaqur me shkollën e lartë që kanë zgjedhur.

PËR SHKOLLAT E LARTA PRIVATE

1) Mbi statusin ligjor të shkollës së lartë dhe të programit të studimit

Shkollat e larta dhe programet e studimit duhet të jenë të licencuara me vendim të

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pas licencimit, shkollat e larta dhe programet akreditohen nga Këshilli i Akreditimit, me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Prandaj, përpara zgjedhjes:

- Kërkoni nga shkolla e lartë: Vendimin për licencimin e programit të studimit, si dhe Urdhrin e Ministrit për akreditimin e programit.

- Sigurohuni që programi i studimit të jetë i akredituar përpara lëshimit të diplomës.

- Klikoni gjithmonë faqen e internetit të APAAL www.aal.edu.al dhe/ose (www.mash.gov.al), për të parë statusin ligjor të institucionit.

- Pyesni nëse kreditet (ECTS) që fitoni aty, janë të transferueshme brenda ose jashtë vendit.

- Pyesni nëse programi bën pjesë në profesionet e rregulluara.

- Interesohuni për mundësinë e punësimit pas përfundimit të studimeve dhe sa për qind e të diplomuarve në programin përkatës janë punësuar.

2) Mbi tarifën e shkollës dhe formën e pagesës

Shkollat e larta duhet të vendosin tarifa shkollimi sipas cilësisë së diplomës që ofrojnë.

Prandaj:

- Informohuni për tarifën e shkollimit dhe për format e pagesës së tyre.

- Tarifat nuk paguhën pa u ofruar shërbimi dhe jo njëherësh për të gjithë programin e studimit.

- Tarifa të favorshme janë tarifat që do të paguhën me këste.

3) Mbi lidhjen e kontratës

Nëse ju vendosni të studioni në një shkollë të lartë private, kontrata që lidhet mes jush dhe shkollës, duhet të jetë në favorin tuaj.

Prandaj:

- Sigurohuni që kontrata të lidhet në prani të një noteri.

- Kërkoni që kontrata të ketë terma të qartë mbi shërbimin që do të merrni, si dhe për format e pagesës së tarifës së shkollimit.

- Kërkoni që në kontratë të vendosen kushtet për të drejtën e çregjistrimit tuaj, nëse shkolla e lartë nuk përmbush detyrat e përcaktuara në të.

- Interesohuni për detyrimet që ka shkolla e lartë ndaj jush, nëse ajo, për shkaqe të ndryshme, ndërpret veprimtarinë e saj.

4) Mbi profesoratin e shkollës

Shkolla e lartë duhet të ketë pedagogë të kualifikuar, me tituj “Master”, “Doktor” e “Profesor”.

Prandaj:

- Njihuni me pedagogët e lëndëve të pro-

- Pyesni studentët aktualë nëse janë të kënaqur me pedagogët.
- Njihuni me numrin e pedagogëve të punësuar me kohë të plotë dhe kualifikimin e tyre.
- Pyesni për tekstet mësimore që përdorin pedagogët, dhe për çmimet e teksteve.

5) Mbi përshtatshmërinë e mjedisit

Mjedisi shkollor duhet të akomodojë të gjitha nevojat për studim të studentëve, për të gjitha programet e studimit që ofrohen. Për programet e mjekësisë, të inxhinierisë e të shkencave natyrore, shkolla e lartë duhet të zotërojë laboratorë për orët e praktikës. Biblioteka duhet të ketë literaturë të përdorshme në orën e mësimit dhe online.

Përpara se të zgjidhni: vizitoni sallat, laboratorët dhe bibliotekën, mje-

diset e praktikave mësimore dhe lidhjen me internet për të gjithë shkollën.

6) Mbi kujdesin ndaj studentëve

Informohuni nga shkolla, si dhe pyesni studentët aktualë:

- Si funksionojnë Programet e Tutoriatit, Këshilli Studentor, si dhe Zyrat e Këshillimit të Studentëve?
- A janë të kënaqur me shkollën që kanë zgjedhur?

Si të zgjedhim programin master?

Programet e studimit të ciklit të dytë përfundojnë me diplomë "Master". Ky program studimi përgatit studentët për tregun e punës dhe për studime të mëtejshme.

Çfarë duhet të dini përpara zgjedhjes së programit?

PËR SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE E PRIVATE

1) Mbi programin e studimit

Kriteret e pranimit vendosen nga Shkolla e Lartë, ndërsa kuotat e pranimit për shkollat publike vendosen nga MASH. Për studimet e ciklit të dytë nuk ka kufizime të moshës apo të kohës që nga diplomimi në ciklin e parë (bachelor). Duke plotësuar kriteret ju mund të studioni edhe degë të përafërta ose të ndryshme nga ajo e ciklit të parë të studimeve.

Profesionet e rregulluara si mjekësia, stomatologjia, farmacia, mësuësia, arkitektura, veterinaria, mami, infermiera, fizioterapia dhe inxhinieria kërkojnë përfundimin e një programi të ciklit të dytë, përpara dhënies së provimit të shtetit.

Përpara zgjedhjes:

- Bazuar në interesat tuaja për të ardhmen sigurohuni mbi dosmodoshmërinë e studimit të një programi master dhe pyesni sa studentë diplomohen në këtë program dhe sa prej tyre janë punësuar.
- Informohuni mbi bashkëpunimin ndërkombëtar të shkollës, si dhe për mundësinë e transferimit të studimeve apo krediteve tuaja në shkolla të tjera brenda apo jashtë vendit.
- Informohuni mirë mbi llojin e programin të studimit për të cilin keni nevojë. Referojuni tabelës :

2) Mbi profesoratin e shkollës

Shkolla e lartë duhet të ketë pedagogë të kualifikuar, me tituj akademikë si "Doktor", "Profesor i asociuar" dhe "Profesor".

- Interesohuni për pedagogët e lëndëve të profesionit, si dhe botimet e tyre. A japin mësim pedagogje të huaja?

- Pyesni studentët aktual nëse janë të kënaqur me pedagogët.
- Pyesni për tekstet mësimore që përdorin pedagogët, dhe për çmimet e tyre.

3) Mbi kujdesin ndaj studentëve

Informohuni nga shkolla, si dhe pyesni studentët aktualë:

- Si funksionojnë Programet e Udhëheqjes, mbrojtja e temës dhe zyra e këshillimit të karrieres.
- A janë studentet aktual të kënaqur me shkollën që kanë zgjedhur?
- Vizitoni sallat, laboratorët dhe bibliotekën, mjediset e praktikave mësimore dhe lidhjen me internet për të gjithë shkollën.
- Informohuni mbi tarifën e studimeve.

	Master i Shkencave	Master Profesional
Qëllimi	njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor	formim të mirëfilltë profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.
Kushti i hyrjes	Së paku Bachelor	Së paku Bachelor
Kohëzgjatja	Së paku 2 vite akademike	Së paku 1.5 vit akademik
Kreditet	120 ECTS	60-90 ECTS
Një nga Kushtet e diplomimit	Gjuha angleze - mbrojtja me teste të njohura ndërkombëtare në nivelin C1	Gjuha angleze - mbrojtja me teste të njohura ndërkombëtare në nivelin B2
Vazhdimi	Studime të doktoratës (Dr.) ose punësim	Punësim ose studime të mëtejshme

Të veçanta për shkollat e larta private

1) Mbi statusin ligjor të shkollës së lartë dhe të programit të studimit
Shkollat e larta dhe programet e studimit duhet të jenë të licencuara me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pas licencimit, shkollat e larta dhe programet akreditohen nga Këshilli i Akreditimit, me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Prandaj, përpara zgjedhjes:

- Kërkon nga shkolla e lartë: Vendimin për licencimin e programit të studimit, si dhe Urdhrin e Ministrit për akreditimin e programit.
- Sigurohuni që programi i studimit të jetë i akredituar përpara lëshimit të diplomës.
- Klikoni gjithmonë faqen e internetit të

APAAL www.aal.edu.al dhe/ose (www.mash.gov.al), për të parë statusin ligjor të institucionit.

- Pyesni nëse kreditet (ECTS) që fitoni aty, janë të transferueshme në shkolla të tjera të larta brenda ose jashtë vendit.

2) Mbi lidhjen e kontratës

Nëse ju vendosni të studioni në një shkollë të lartë private, kontrata që lidhet mes jush dhe shkollës, duhet të jetë në favorin tuaj. Mos filloni studimet pa kontratë!

- Sigurohuni që kontrata të lidhet përpara fillimit të studimeve, në prani të noterit, të ketë terma të qartë për shërbimin që do të merrni, si dhe për format e pagesës së tarifës së shkollimit.
- Sapo të regjistrohni kërkon numrin e imatrikullimit. Ky numër del edhe në diplomën tuaj.

- Tarifa e shkollimit vendoset sipas cilësisë së diplomës që ofrojnë dhe nuk paguhet përpara marrjes së shërbimit. Kërkon që në kontratë të vendosen kushtet për të drejtën e çregjistrimit tuaj, nëse shkolla e lartë nuk përmbush detyrat e përcaktuara në të.

- Interesohuni për detyrimet që ka shkolla e lartë ndaj jush, nëse ajo, për shkaqe të ndryshme, ndërpret veprimtarinë e saj.

- Nëse konstaton që shkolla e lartë nuk ofron cilësinë e premtuar të studimeve dhe kushtet e parashkruara në kontratë, kërkon menjëherë të çregjistroheni.

Për informacion më të hollësishëm:

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS:

www.mash.gov.al
Tel: 4 2230289

AGJENCIA PUBLIKE E
AKREDITIMIT:

www.aal.edu.al
Tel: 04 2 225322

Me drejtorin e ZA Malësi e Madhe, zotin Ardian Lulaj

1. Jeni ndër drejtorët më me eksperiencë të Zyrës së Arsimit. Ju lutem na thoni ç' histori ka përbërë arsimit në Malësinë e Madhe ?

Në rrethin e Malësisë së Madhe si në të gjithë vendin , faktorët historik kanë përcaktuar nivelin e zhvillimit në tërë aspektet e jetës, përfshirë edhe atë arsimor . Historia e arsimit në këtë rreth në aspektin e funksionimit të shkollës shqipe zë fill që më 1891 kur hapet shkolla e parë shqipe në fshatin Selcë të komunës Kelmend . U pasua më 1893 në Bajzë të komunës Kastart e më pas në Rrjoll dhe fshatra të tjera , ku shkollat shqipe u hapën pranë kishave katolike . Pas shpalljes së pavarësisë dhe me fillimet e funksionimit të shtetit shqiptar , u hapën shumë shkolla laike me ndihmesën edhe të shumë figurave të njohura të arsimit shqiptar . Pas vitit 1944 një ngjarje e rëndësishme në jetën arsimore ishte hapja e gjimnazit të Koplikut në vitet 1960 , i cili u bë qendra kryesore e arsimit në tërë zonën. Sot në rrethin M. e Madhe funksionojnë 3 gjimnaze, 4 shkolla të mesme të bashkuara, 23 shkolla 9 - vjeçare (5 vartëse), 33 kopshte dhe 1 QKF. Në këto institucione shkollore vijojnë mësimin 800 fëmijë në arsimin parashkollor, 5300 nxënë në arsimin bazë dhe 1500 nxënë në gjimnaz. Krahas arsimit publik funksionon edhe ai jopublik (1 shkollë 9 - vjeçare me 52 nxënës dhe tre kopshte me 114 fëmijë).

2. Dihet se nuk jeni ndër zyrat “e mëdha“ të vendit , por ç' vend zënë problemet në arsimin e M. Madhe dhe komunikimi juaj me pjesë të stafit dhe kolektivat e mësuesve?

Reforma në sistemin arsimor parauniversitar ka patur edhe problemet e saj , probleme të cilat tani konsiderohen të papërfillshme. Në saj të reformave të ndërmarra ndër vite në zbatim të Udhëzimeve të MASH, këtë vit shkollor të gjitha emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar janë bërë në përputhje me Udhëzimin Nr. 22, datë 29. 07. 2010 të MASH. Të gjitha arritjet në fushën e arsimit janë fryt i një gjuhe bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të ndërsjelltë mes stafit të ZA dhe shkollave duke përfshirë edhe organet kolegjiale në shkollë .

3. Kohët e fundit edhe ju jeni përfshirë në mënyrë aktive në diskutimin e projektligjit për arsimin parauniversitar. Ç'mendime keni për këtë projektligj, risitë dhe sygjerimet tuaja?

Fillimisht jemi njohur me projektligjin e arsimit parauniversitar duke e marrë nga web site i MASH duke ua përcjellë një kopje të gjitha shkollave dhe pastaj edhe përmes Nr. 12 të revistës “Mësuesi“. E vlerësojmë projektligjin si një ngjarje e madhe arsimore, pasi kemi besimin e plotë që nisur edhe me përmirësimet që do t' i bëhen nga marrja në konsideratë e opinioneve , mendimeve dhe sugjerimeve të vlefshme të aktorëve të përfshirë në diskutimin e hapur publik . Mendojmë se ky projekt do të jetë ligj arsimor i standarteve evropiane . Si risi vlerësojmë : Ligji i ri është shumë i detajuar në krahasim me ligjin e mëparshëm duke mos lënë shteg për keqinterpretim . Kalimi i ciklit fillor në gjashtë vite shkollimi , mendojmë se është një arritje si dhe vlerësimi me shprehje deri në klasën e tretë dhe kalimi pa mbetje është një hap drejt standartit evropian (Neni 51 , 55) . (Neni 79) Nxënësit me prirje të veçanta përbën një risi në arsimin tonë . Sygjerimet : (Neni 28) Pavarësia financiare e shkollave do të ishte në të mirë të shërbimit të nxënësve. (Neni 3) Niveli 0 - ro që



përfshin arsimin parashkollor nuk na duket i përshtatshëm pasi sistemi i numërimit fillon nga numri 1 dhe niveli 0 - ro në masën e gjerë tingëllon jo mirë si koncept. Arsimimi i fëmijëve në kushtet e shtëpisë për arsye të ndryshme lë vend për abuzim. Funksionimi i organizmave pranë shkollave kanë kompetenca të cilat nuk realizohen duke i orientuar drejt formalizmit.

4. Realizimi i reformave të ju, edhe pse jeni në skajin verior të vendit, duket se zë vendin kryesor të punës suaj. Ju lutemi mund të na thoni si po implementohen ato në M. e Madhe?

Krahas investimeve në infrastrukturën shkollore , mendoj se suksesi më i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shkollimit të nxënësve është reforma shkencore e personelit mësimor . Kemi bërë të gjitha përpjekjet që burimet njerëzore në fushën e drejtimit dhe mesimdhënies të jenë të diplomuar dhe të kualifikuar. Mësuesit janë të emëruar dhe sistemuar në punë sipas nivelit dhe titullit të diplomës . Mësues pa nivelin e duhur arsimor (përfshirë edhe ata me arsim pedagogjik , artistik apo edukim fizik) të cilët nuk kanë fituar të gjitha shkallët e kualifikimi , nuk janë pjesë e sistemit tonë arsimor . Bëjnë përjashtim vetëm dy shkolla 9 – vjeç. të komunës Kelmend ku largësia gjeografike dhe terreni tepër i thyer malor kushtëzon mësuesit në pritmëri për të punuar në këto shkolla . Duhet theksuar fakti se vetëm këtë vit në shkollat e kësaj komune kanë pranuar të aktivizohet shtatë mësues të diplomuar me arsim të lartë .

5. Po hyjmë në fazën e parë të Maturës Shtetërore 2011. Mund të na thoni se si po ecën këtë vit kjo reformë tek ju ?

Ne tanimë kemi fituar një përvojë pozitive të konsoliduar në procesin e Maturës Shtetërore . Jemi ndër rrethet ku në pesë vitet e implementimit të Maturës Shtetërore , jemi vlerësuar nga MASH si një ndër rrethet më korrekte në menaxhimin e këtij procesi nga më të rëndësishmit në arsimin e mesëm . Rregullorja për “zhvillimin e provimeve të M SH 2011 në Republikën e Shqipërisë “ është tani pjesë e çdo gjimnazi . Në zbatim të kësaj rregulloreje kemi ngritur komisionin e Maturës Shtetërore 2011 të Zyrës Arsimore dhe jemi në pritje deri më 13 shkurt për miratimin e komisioneve shkollore të maturës shtetërore . Besojmë që edhe këtë vit ashtu si vitet e tjera , nga konsolidimi i përvojës së fituar , Matura Shtetërore në rrethin tonë do të kurorëzohet me sukses.

Faleminderit për mirëkuptimin .

Kurrikula e re e gjimnazit - nxënësit - shkolla

Struktura e re e gjimnazit mundëson përzgjedhje individuale të larmishme, në mënyrë që nxënësi të përballojnë me sukses ndryshimet dhe të përshtaten me kurrikulën me zgjedhje. Kurrikula e re e gjimnazit, e organizuar në kurrikulë bërthamë dhe kurrikulë me zgjedhje (të detyruar dhe të lirë), e lejon nxënësin që ai të marrë tri herë vendime për itinerarin e tij kurrikular. Këta nxënësi e bën në fillim të çdo viti shkollor. Organizimi i ri i mundëson nxënësit një formim të përgjithshëm më të plotë, e bën atë më të zot për çfarëdo dege të shkollës së lartë, përfshirë dhe degët profesionale. Kurrikula bërthamë është e detyruar dhe e njëjtë për të gjithë nxënësit.

PYETJE

Një klasë, që ka zhvilluar modulën "Volejbol" si zgjedhje e lirë në klasën e 10-të.

A mundet të përzgjedhë një modul tjetër tek lojërat sportive, p.sh., "Futboll" në klasën e 11-të po për zgjedhje të lirë?

PËRGJIGJE

Për saktësi, nuk është "klasa" që përzgjedh, por "nxënësi", dhe pastaj bashkohen në një klasë ata nxënës që kanë përzgjedhur po atë lëndë/modul.

Një nxënës që ka përzgjedhur modulën "Volejbol" si zgjedhje e lirë në klasën e 10-të, mundet të përzgjedhë modulën "Futboll" në klasën e 11-të.

Disa nxënës janë të prirur ndaj sporteve dhe ata mund të përzgjedhin lëndë/module me sportet të lëndët me zgjedhje të detyruar edhe ato me zgjedhje të lirë.

Po kështu, të tjerë nxënës mundet të përzgjedhin kryesisht tek artet dhe të tjerë kryesisht module profesionale.

PYETJE

Në udhëzimin për gjimnazin thuhet se "Për lëndët pa notë nuk llogariten pikë" dhe si shembull jepet "Përforcimi". A mund të listoni dhe lëndë apo module të tjera veç "Shërbimit komunitar"?

PËRGJIGJE

Vetëm këto janë: Përforcimi dhe shërbimi komunitar.

PYETJE

A lejohet që për një lëndë ose modul me zgjedhje (të detyruar ose të lirë) të krijohet një klasë me nxënës të gjimnazeve të ndryshme?

PËRGJIGJE

Po, lejohet. DAR ose ZA kanë rolin kryesor për të ndihmuar drejtorët e gjimnazeve për ngritjen e klasave të tilla.

PYETJE

Për të nxjerrë notën përfundimtare të një lënde, përfshihen të gjitha notat e nxënësit në atë lëndë nga fillimi e deri në fund të vitit, me peshë të përcaktuara. (50%, 40%, 10%) Për semestrin e parë (pavarësisht se kjo nuk ndikon në përfundimtarën vjetore), a është e detyrueshme të ketë në regjistër kolonë me "përfundime"?

PËRGJIGJE

Nuk është e detyrueshme.

Mësuesi kujdestar i njofton prindërit e nxënësve të gjitha notat e lëndëve të semestrin të parë. Drejtorja e shkollës, nga ana e saj, analizon gjendjen e nxënësve mbi bazën e këtyre notave dhe planifikon, së bashku me mësuesit dhe bordin e shkollës, përmirësimet në arritjet e nxënësve.

PYETJE

Nëse një nxënës në qershor ka mbetur në vjeshtë në matematikë dhe në sesionin e dytë rezultoi kalues, a do t'i njihet direkt krediti në përforcim apo do t'i nënshtrohet vjeshtës dhe për përforcimin?

PËRGJIGJE

Derisa nxënësi përfundimisht nuk është mbetës në lëndën e matematikës, ai i fiton kreditet e përforcimit në matematikë.

PYETJE

A do të ketë kontroll njohurish për orët mësimore të munguara nga nxënësi? A bie 20% i mungesave?

PËRGJIGJE

Rregulli i 20% të mungesave nuk është anuluar ndokund.

Numri i provimeve me shkrim për kapitujt me të gjithë nxënësit e një klase në një lëndë të caktuar është parashikuar nga mësuesi qysh në fillim të vitit shkollor. Nëse nxënësi, që ka munguar, nuk ka marrë pjesë në provime të tilla për shkak të mungesave, ai duhet t'u nënshtrohet këtyre provimeve.

PYETJE

Nxënësve që kanë ardhur nga shkolla 9-vjeçare pa gjuhë të huaj, ne u kemi ofruar gjuhë të huaj me nga tri orë në javë si gjuha e huaj e parë. A duhej të vepronim kështu?

PËRGJIGJE

Nxënësit përzgjedhin si gjuhë të huaj të parë atë gjuhë të huaj që kanë mësuar në arsimin bazë. Në këtë rast, programi lëndor është vazhdim i programit përkatës në arsimin bazë. Kjo gjuhë e huaj e parë mësohet për tri orë në javë, pra, ka tri kredite.

Nxënësi, që ka ardhur nga arsimi bazë pa gjuhë të huaj, nis nga fillimi një gjuhë të huaj. Programi i saj është me dy orë në javë, pra, lënda ka dy kredite, jo më shumë.

PYETJE

Për nxënësit që kanë kaluar nga matematika e thelluar në letërsinë e thelluar, si do të bëhet plotësimi i amzave?

PËRGJIGJE

Në amëz shkruhen lëndët që nxënësi ka mësuar në çdo klasë dhe kreditet përkatëse. Për nxënësin, që në klasën e 10-të ka mësuar matematikën e thelluar, kurse në klasën e 11-të letërsinë e thelluar, në amëz për klasën e 10-të shënohet matematika e thelluar, kurse në klasën e 11-të shënohet letërsia e thelluar.

PYETJE

Si përllogaritet norma mësimore e një mësuesi për projektin kurrikular shkollor duke

pasur parasysh që shkolla duhet të ofrojë për tre vjet 18 orë projekt kurrikular.

PËRGJIGJE

Ekipi kurrikular i shkollës përcakton sa orë mësimore do të zhvillojë çdo mësues i përfshirë te një projekt kurrikular në nivel shkollë.

Me "orë mësimore" kuptojmë orët që mësuesi ose mësuesit zhvillojnë me nxënësit e klasës ashtu si orët e lëndëve.

Shuma e këtyre orëve për çdo nxënës për projekte kurrikular në nivel shkollë duhet të jetë 18. Puna e nxënësve në kuadrin e projektit kurrikular nuk përfshihet në këto 18 orë, ashtu si nuk përfshihen orët e punës së nxënësit jashtë shkollë për lëndën e matematikës, kurse si orët të mësuesit të matematikës janë ato që mësuesi zhvillon në klasë me nxënësit e tij.

PYETJE

Gjimnazet private a i kanë koeficientet e lëndëve me zgjedhje njësoj si gjimnazet publike?

PËRGJIGJE

Nuk kanë asnjë ndryshim nga gjimnazet publike.

PYETJE

Unë kam në dorë Udhëzuesin e ri të kurrikulës (të ripunuar), dhe do doja t'ju pyesja nëse mund ta përdorim atë si dokument zyrtar për problemet e shumta që na lindin gjatë zbatimit të saj? Në shumicën e rasteve përgjigjet i gjejmë të qarta aty.

PËRGJIGJE

Udhëzuesi i ripunuar i kurrikulës është dokument zyrtar. Ju mund ta keni vënë re se, që në krye, është mesazhi që mban firmën e Z. Myqerem Tafaj, Ministër i Arsimit.

PYETJE

Një vajzë deri tani ka vazhduar gjimnazin në klasën e 11-të, por do të kalojë në gjimnaz me kohë të shkurtuar.

A realizohet një gjë e tillë në semestrin e dytë?

PËRGJIGJE

Rregullat e transferimit të një nxënësi nga shkolla me kohë të plotë në atë me kohë të shkurtuar nuk kanë ndryshuar.

PYETJE

Nëse një nxënës ka zhvilluar teatrin në klasën e 10-të në fushën e arteve dhe në gjysmën e parë të klasës së 11-të po këtë modul. Nota përfundimtare do të dalë veç për klasën e 10-të dhe veç për klasën e 11-të apo duke u mbështetur te moduli?

PËRGJIGJE

Nota përfundimtare e një klase është për artet, kështu që do të dalë një notë përfundimtare për klasën e 10-të dhe një tjetër për klasën e 11-të.

SHËNIM

Në faqen 167 tek "Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit", tek tabela e shembullit, ka një lapsus. Gjuha e huaj e parë ka 2 kredite dhe historia ka 3 kredite. Numri i krediteve, duke qenë numri i orëve javore, jepet i saktë në tabelën 2 të faqes 20 të këtij Udhëzuesi.

Projektligji i Arsimit Parauniversitar, drejt fazës përmbyllëse

Pranë redaksisë së revistës “Mësuesi” vijojnë të vijnë ide, mendime e sugjerime rreth Projektligjit të arsimit Parauniversitar, për të cilin, përmbyllet tashmë faza e diskutimit dhe vjeljes së mendimeve dhe ideve për përmirësimin sa më të plotë të tij, dhe tashmë grupi i punës së hartimit të këtij drafti është duke relatuar vërejtjet më të qenësishme për përmirësimin e tij. Së shpejti ky projektligj do të kalojë në Parlament për tu miratuar.

Elbasan

Me drejtorin e shkollës “Luigj Gurakuqi” Fatos Bajraktari.

E kemi lexuar Projektligjin dhe e diskutuam edhe me stafin pedagogjik. Kemi këto mendime:

Neni 3 pika d, shihet që niveli 2 ndodhet edhe në “Arsimin bazë” po ashtu edhe në “Arsimin e mesëm” të sqarohet.

2. Neni 16, pika 2 mendojmë të jetë: Klasat e seksioneve dygjuhëshe në gjimnaz dhe në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja.....

Neni 19, pika3, duhet sqaruar se cilat janë ato profesione që nxënësi merr në arsimin bazë që të jenë në dobi të qytetarëve?

Neni 22, deri sa shteti siguron konvikte dhe mjete të tjera lehtësuese pse të mos përcaktohet edhe grupimi i shkollave të mesme të fshatrave, që të vijnë të vazhdojnë shkollën e mesme në qytet, se edhe kushtet janë më të mira dhe lehtësuese.

Neni 54, është një arritje që tek ne u bënë disa vjet që punohet me tekste alternative, por përzgjedhja e tyre është e mira të bëhet në bazë rrethi nga mësues specialist dhe jo 100 shkolla 100 tekste.

Neni 55, pika3, jemi dakord me këtë pikë se tregon zhvillim dhe dalëngadalë na barazon me vendet e Europës.

Neni 57, të sqarohet se kush do ta hedhi shortin, apo njësia arsimore vendore.

Neni 60, pika1, mësuesit mendojë se mos duhet parë më mirë, sepse para 2-3 vjetësh u bë një gjë e tillë dhe nuk dha ndonjë rezultat aq të mirë, por duhen gjetur modalitete që mësuesin ta vënë para përgjegjësisë si administrator.

Neni 64, pika 4, mirë është theksuar në këtë pikë, por ky fond duhet përcaktuar qoftë nga njësia vendore se nga njësia vendore arsimore, besoj duke u mbështetur në akte nënligjore që mund ta plotësojnë këtë .

Neni 66, pika 2/b, të jetë: arritjet e nxënësve në provimet e arsimit bazë, ose të MSH për dy vite të njëpasnjëshme janë në 5% e fundit në renditjen e shkollave në nivel kombëtar.

Neni 68, mirë bëhet që mësuesi të japë provimin e shtetit dhe të formohet Urdhëri i Mësuesit, po a nuk mund të kalohet që mësuesi të ketë Status.

Nuk flitet për shkolla me Status Kombëtar se si do të procedohet me to. Në përgjithësi ky p/ligj është i saktë dhe mbart me vete të gjithë gamën e gjerë të problemeve dhe rregullimin e tyre me ligj si e kërkon edhe koha.

Me drejtorin e shkollës “Xhaferr Kongoli” Suzana Janku.

Ky projektligj synon ta sjellë arsimin më afër nxënësve të cilët janë përfituesit e drejtpërdrejtë të tij. Në këtë projektligj u krijohet mundësia për t’u arsimuar në sistemin arsimor parauniversitar një gamë të gjerë moshash. Në nenin 14-të të këtij projektligji janë përcaktuar llojet e shkollave duke

përcaktuar të funksionojnë shkolla me kohë të plotë, me kohë të pjesshme dhe korrespondencë. Kjo dispozitë ligjore do të sjellë funksionimin e një lloji të ri të shkollës me kohë të pjesshme dhe korrespondencë. Në këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar vija ndarëse dhe ndryshimi në mënyrën e funksionimit të shkollës me kohë të pjesshme dhe asaj me korrespondencë. Mendoj që kjo dispozitë ligjore duhet të përcaktojë në vija të përgjithshme mënyrën e funksionimit të shkollës me kohë të pjesshme dhe asaj me korrespondencë.

Paragrafi i dytë i nenit duket se nuk gjen lidhje me përmbylletjen e kësaj dispozite ligjore. Sugjeroj dhe mendoj që ky paragraf të rishikohet dhe të vendoset në një dispozite tjetër, pasi me këtë nen duhet të bëhet rregullimi i mënyrës së funksionimit të llojeve të ndryshme të shkollave. Një rregullim më i mirë ligjor i funksionimit të këtyre shkollave do të sqaronte më mirë paragrafët e fundit të neneve 20 dhe 21.

Pa dyshim është për t’u vlerësuar që edhe atyre që nuk kanë mbaruar dot arsimin bazë në moshën 16 vjeç u ofrohet mundësia që ta përfundojnë këtë arsim, nëpërmjet shkollës me kohë të pjesshme dhe me korrespondencë e parashikuar si detyrim ligjor në nenin 20, paragrafi i katërt. E njëjta gjë është parashikuar dhe për ata persona që kanë mbushur moshën 20 vjeç dhe nuk kanë përfunduar gjimnazin duke u dhënë mundësinë që ta mbarojnë këtë arsim në shkollat me kohë të pjesshme, ose në shkollat me korrespondencë. Gjithashtu, në ligj është futur dhe koncepti i të nxënësve në distancë për nxënësit. Pavarësisht se në këtë projektligj nuk ka një rregullim të plotë ligjor, në nenin 22 duhet të jetë Ministria ajo që duhet të nxisë funksionimin e të nxënësve në distancë.

Malësi e Madhe

Takimin e parë redaksia e revistës “Mësuesi” e bëri me drejtorin e Za - Malësi e Madhe, z. Ardian LULAJ, i cili na informoi mbi ecurinë e punës së kolektivave të shkollave në diskutimin për Projektligjin. Si fillim, Zyra Arsimore, kishte kërkuar që të gjithë mësuesit, edukatorët e kopshteve, qeveritë e nxënësve, bordi i shkollave të njiheshin me Projektligjin, duke ua shpërndarë të printuar, por edhe nëpërmjet revistës “Mësuesi” Më pas, kishin hartuar planin e veprimtarisë, ku në plan të parë ishte diskutimi dhe, më pas, vjelja e mendimeve. Ne kontaktuam me disa kolektiva shkollash të kësaj drejtorie për të marrë nga afër mendimet e tyre.

Në shkollën ‘Abdyl Bajraktari’ me 1500 nxënës dhe 50 mësues, drejtoresha e shkollës, Znj. Nafije Duka, pasi na tregoi se të gjithë mësuesit ishin njohur nëpërmjet revistës “Mësuesi” me Projektligjin, duke vlerësuar risitë na dha këto mendime:

Të rishikohet vlerësimi i nxënësve të klasë 1-3 të Ciklit Fillor, pasi vlerësimi vetëm me shprehje mund të sjelli uljen e cilësisë në procesin mësimor.

Inspektori i Za, z. Faik ndërhyr duke u ndalur në përcaktimin e niveleve të shkollimit duke thënë që për Ciklin Fillor të jetë niveli 1 jo niveli 0, kjo të jetë për kopshtet.

Mendime na dhanë edhe n/drejtoret e kësaj shkolle znj. Esmerina Hebah, Vera Deda dhe Liza Naçe. Ato vlerësojnë risitë e këtij Projektligji si neni për mësuesin ndihmës, për bordin e shkollës dhe kompetencat e drejtorit.

Me drejtorin e gjimnazit “Sherif Hoxha” Z. Shaban Duka. Në planin e punës një vend të veçantë zinte diskutimi i këtij Projektligji me Qeverinë e nxënësve. Në këtë takim, ne kontaktuam edhe me presidentin e kësaj qeverie, nxënësin e kl. 12 Besian Ymeri, cili vlerësoi risitë sidomos kalimin e nga gjimnazi i profilizuar duke vlerësuar kurrikulën e re të këtij gjimnazi në lidhje me lëndët me zgjedhje dhe vlerësimin e nxënësve.

Statusi i mësuesit - një nga kolonat kryesore të projekt-ligjit të ri

Nisma që ka ndërmarrë MASH për hartimin e Ligjit të ri për arsimin parauniversitar përbën një hap dhe moment me rëndësi në zhvillimin dhe konsolidimin e procesit të reformimit të këtij sistemi. Qëllimi i Ligjit të ri është të legjitimojë reformat e reja që janë ndërmarrë në të gjithë nivelet e arsimit parauniversitar, t'u japë hapësirë dhe të inkurajojë zhvillimin e pandërprerë të këtyre ndryshimeve për të mundësuar që shkolla të ofrojnë një arsim cilësor dhe shanse të barabarta për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Për hartimin e një Ligji të tillë janë të interesuar të gjithë: shteti, institucionet arsimore publike e private, partnerët social, mësuesit, prindërit, nxënësit dhe gjithë shoqëria.

Kjo është arsyeja që sindikatat e arsimit, nga shkollat deri në nivel qendror, u përfshin në diskutimin për përmirësimin e draftit të Ligjit për arsimin parauniversitar. FSASH u angazhua aktivisht dhe mori përsipër që të japë ndihmesën e saj në dy momente kyçe të Projekt-Ligjit.

Se pari, FSASH ka bërë sugjerime dhe propozime që lidhen me harmonizimin e Projekt-Ligjit me Konventat Ndërkombëtare të Punës dhe me Ligjin për Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Në Projektligjin e ri "Për arsimin parauniversitar" përfshihen dispozita që trajtojnë marrëdhëniet e punës, raportet me partnerët social, me shoqatat e prindërve dhe nxënësve, me të drejtat dhe detyrat e mësuesve, me sistemin e pagave e të shpërblimeve, etj. Është e domosdoshme që dispozitat e Ligjit të ri për këto çështje të jenë të harmonizuara si me Konventat Ndërkombëtare të Punës, të cilat janë miratuar nga shteti ynë, sepse këto konventa përbëjnë standarde bashkëkohore për tërësinë e marrëdhënieve të punës, ashtu edhe me dispozitat e Kodit të Punës.

Së dyti, FSASH është angazhuar për të përfshirë në Ligjin e ri një nga kërkesat e hershme të saj, dispozitat për Statusin e Mësuesit. Në të vërtetë, ndryshe nga ligji që është sot në fuqi dhe nga ligjet e mëparshme, hartuesit e Projektligjit të ri, për herë të parë kanë përfshirë në projekt disa dispozita që lidhen me mësuesin. Në sugjerimet e veta FSASH, duke u mbështetur në këto dispozita dhe ka përpunuar kreun që titullohet "Statusi i Mësuesit".

Statusi që u garantohet mësuesve nëpërmjet këtij ligji, është shprehje e qëndrimit, vlerësimit dhe konsideratës që ka shoqëria dhe shteti për figurën, profesionin, misionin dhe punën e mësuesit. Në Ligjin e ri, për herë të parë, mësuesi legjitimohet si figura qendrore e shkollës, vlerësim ky i merituar, sepse mësuesit luajnë rol thelbësor për zhvillimin bashkëkohor të sistemit arsimor në vend dhe, nëpërmjet arsimit të brezit të ri japin një kontribut të pazëvendësueshëm për zhvillimin e individit dhe të shoqërisë moderne, formojnë inteligjencën tekniko-shkencore, si bazë për progres të vazhdueshëm jo vetëm kulturor dhe moral, por edhe ekonomik e social të vendit.

Statusi që propozohet të gëzojnë mësuesit me këtë ligj, në përputhje me "Rekomandimin e ILO-s dhe UNESCO-s "Për Statusin e Mësuesit", u garanton atyre standarde bashkëkohore në çdo fazë të procesit për fitimin dhe ushtrimin e profesionit, përfshirë përgatitjen profesionale dhe përcaktimin e institucioneve që autorizohen të bëjnë këtë përgatitje, vendos kritere për procesin e kualifikimit shkencor të vazhdueshëm, për punësimin dhe karrierën, për pagat, shpërblimet dhe sigurimet shoqërore, fikson të drejtat dhe detyrat e mësuesve, bazuar në standarde bashkëkohore, garanton kushtet për një mësimdhënie dhe të mësuar të efektshëm, etj.

Sipas Projektligjit të ri, Statusi përfshin të gjithë mësuesit, si në shkollat publike dhe ato private, duke filluar nga arsimi parashkollor, arsimi bazë, i ulët dhe i lartë dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional.

Projektligji përcakton se Autoriteti që kujdeset dhe mbikëqyr

Nga Xhafer DOBRUSHI, Kryetar i FSASH

respektimin e dispozitave të "Statusit të Mësuesit" është sindikata, ose sindikatat më të përfaqësuara, nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

Në kreun X të Projektligjit për "STATUSIN E MËSUESIT", sipas sugjerimeve të FSASH, theksohet se "në këtë ligj janë përfshirë të drejtat dhe detyrat e mësuesve që përbëjnë standarde bashkëkohore. Ndërsa, detajimi dhe konkretizimi në hollësi i këtyre të drejtave dhe detyrave bëhet me akte normative që nxjerr Ministri dhe me Kontratën Kolektive të nivelit të parë.

Mendimi ynë është se të drejtat dhe detyrat kryesore të mësuesit, që përbëjnë standarde dhe që duhet të sanksionohen në dispozitat e ligjit janë:

Liria profesionale dhe akademike, që do të thotë se:

- Mësuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hartimit të teksteve, mjeteve të mësimdhënies dhe programeve e planeve mësimore.
- Çdo sistem kontrolli mbi punën e mësuesit duhet t'i inkurajojë dhe ndihmojë ata për kryerjen me cilësi të detyrave të tyre profesionale, duke mos kufizuar lirinë, iniciativën dhe përgjegjësinë e mësuesve.
- Mësuesi duhet të njihet me vlerësimet që i bëhen punës së tij nga punëdhënësi. Ai ka të drejtën e apelimit të këtyre vlerësimeve.
- Mësuesit janë të lirë të përdorin metoda të përshtatshme



bashkëkohore për të vlerësuar përparimin e nxënësve, me kusht që vlerësimi të jetë objektiv dhe të përjashtojë çdo subjektivizëm dhe padrejtësi.

- Autoritetet e arsimit duhet të marrin në konsideratë opinionet dhe rekomandimet e mësuesve për aftësitë, talentet dhe përshtatshmërinë e nxënësve në përzgjedhjen e degëve dhe profesioneve në arsimimin e mëtejshëm.
- Shqyrtimi i ankesave të nxënësve, apo prindërve kundër mësuesve, në çdo rast duhet t'u krijojë mësuesve mundësinë për t'u mbrojtur në bazë të dispozitave të këtij Ligji dhe Kontratës Kolektive të Punës.
- Autoritetet e arsimit, pushteti vendor dhe organet e rendit duhet ta mbrojnë mësuesin nga kërcënimet, rreziqet dhe çdo formë tjetër presioni, apo dhune që ushtrohet ndaj tyre për shkak të profesionit, përfshirë këtu edhe fyerjet apo çdo sjellje jo korrekte të nxënësve ndaj tyre në shkollë, ose jashtë saj. Te drejta civile që kushtëzohen (lidhen) me profesionin e mësuesit:
- Pjesëmarrja aktive e mësuesve në jetën shoqërore dhe publike garantohet me ligj. Ajo është në interes të zhvillimit të vetë mësuesve, të shërbimeve që ofron shkolla dhe në interes të shoqërisë në përgjithësi.

• Mësuesi gëzon lirinë për të përfutur dhe ushtruar të gjitha të drejtat civile që gëzojnë qytetarët e tjerë, përfshirë edhe të drejtën për t'u zgjedhur në organet e pushtetit qendror, ose vendor dhe në administratën publike.

• Kur detyrat në organet e pushtetit, apo administratën publike janë të tilla që mësuesi nuk mund të ushtrojë njëkohësisht edhe profesionin e tij si mësues, ai ruan të drejtën e vjetërsisë në punë dhe, me mbarimin e mandatit kthehet në profesionin e mëparshëm.

Të drejta që realizohen nëpërmjet organizatave përfaqësuese, sindikatave.

Siç është sanksionuar në Ligjin nr. 7961 date 12.7.1995 "Për Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë" dhe në përputhje me Konventat e ILO-s nr. 87 "Për lirinë sindikale..." dhe Konventën nr. 98 "Për të drejtën e organizimit dhe të bisedimeve kolektive", mësuesve u garantohet e drejta që nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese sindikale të negociojnë me punëdhënësin publik, ose privat për pagat, shpërblimet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore; për standardet dhe kriteret e punësimit, për karrierën dhe kualifikimin, për mosmarrëveshjet që lindin në procesin e marrëdhënieve të punës; për kushtet e punës, për kohën e punës dhe pushimet javore e vjetore, etj.

Projektligji për arsimin parauniversitar, risi për në BE

Përgatiti: Bashkim SALIASI

Burimet e kontakteve tona me projektligjin janë të shumta, përmes Drejtorive të shkollave, Revistës "Mësuesi" por dhe një emision të gjerë e të plotë të diskutuar me mësuesit e Qarkut të Korçës dhe ministrit të shfaqur në Televizionin Shqiptar. Në këtë emision Ministri i Arsimit, Zoti Myqerem Tafaj shpalosi platformën e projektligjit për arsimin parauniversitar. Ky projektligj tregon përpjekjen serioze për të përmirësuar sistemin tonë parauniversitar. Në këtë projektligj i bazuar sipas standardeve Evropiane, kuptojmë se objektivi i përgjithshëm është përmirësimi i cilësisë dhe kushteve të mësimit në të gjithë nxënësit.

Këto arritje duken në angazhimin e Institutit të drejtimit të cilësisë së arsimit në hartimin e programeve mësimore, kualifikimin e mësuesve, kualifikimin e drejtuesve të shkollës, përzgjedhjen e teksteve shkollë etj. Faktor i rëndësishëm në garantimin e suksesit që parashikohet në projektligj është Neni 70, pika 3, kreu i X që thotë:

- Mësuesi ka për detyrë: a) të përmbushë objektivat e të nxënësve të çdo nxënësi të tij dhe të zhvillojë mësuesi/nxënësi me në qendër nxënësin; b) të përmbushë standardet e mësuesit në përgjithësi dhe të lëndës, në veçanti; c) të vetëvlerësohet sipas objektivave të të nxënësve për nxënësin e tij, ç) të përditësojë përditë vazhdimisht aftësitë e tij profesionale, d) të bashkëpunojë me kolegët për zhvillimin profesional; dhe të jap ndihmesën e tij për përparimin e institucionit ku punon. Në qendër të tij më duket se vendoset me të drejtë figura e mësuesit. Projektligji synon që arsimtari të krijoj një koncept të ri në rritjen e përgjegjësisë në këtë fazë të zhvillimit të reformave arsimore në Republikën Popullore të Shqipërisë. Sfidat që bëjnë me formimin shkencor dhe profesional të vazhdueshëm për t'u përgjigjur nevojave dhe detyrimeve që ka përpara shkolla. Në projektligj bëhet e qartë se çdo mësues duhet të ndërjegjësohet se, detyra parësore që del para tyre është reformimi. E kuptuar ndryshe çdo mësuesi i del për detyrë që të udhëheq dhe të menaxhojë me kompetencë profesionale lëndën e tij. Projektligji vendos standarde të përparura në formimin universitar të mësuesve të rinj dhe kualifikimin e vazhdueshëm të mësuesve në detyrë (profesion i rregulluar; master i shkencave në edukim për të tre nivelet e APU sipas modelit të Finlandës, kualifikimi i vazhdueshëm sipas modeleve të përparura).

Niveli i zhvillimit të fëmijëve shqiptar është i barabartë me bashkëmoshatarët e vendeve evropiane dhe këtë e

dëshmon dhe vlerësimi i PISA. Projektligji konsolidon strukturën e sistemit tonë të APU, ku për herë të parë, ai shprehet për bërjen gati të klasës së detyrueshme parapërgatitore të arsimit parashkollor (çdo fëmijë 5-vjeçar duhet të vijojë së paku 1 vit arsim parashkollor përpara regjistrimit në klasën e parë)

Një ndër pikat e projektligjit, neni 15, "Arsimimi në kushtet e shtëpisë dhe në institucione joshkollë". Opinioni mbarë kombëtarë i cili shpreh vullnetin e lirë e pranon këtë projektligj dhe kjo duket dhe nga reagimet në media dhe në shtypin e shkruar. Një tjetër pikë e fortë është dhe parashikimi i funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar. Në këtë projektligj sanksionohet qartë roli i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, në të cilin bëjnë pjesë figura të njohura publike për arsimin. Në nivel Qarku, ngrihet një Këshill ekspertësh që funksionon pranë Prefektit.

Problematika më e madhe e këtij projektligji qëndron tek neni 36, pika 4, në të cilin shprehet: "Ndalohej ekspozimi i simboleve fetare në institucionet arsimore, përveç se në shkollat ku mësohen lëndë fetare" - Kjo pikë e veçantë ka sjell në shtypin e përditshëm mjaft refleksione nga analistë e gazetarë të ndryshëm. Deri tani ne nuk na ka penguar në procesin e mësimit, prania e ndonjë shamie, sikundër nuk kemi parë asnjë simbol fetar të ekspozuar në mjediset e shkollës, si kryqe e gjysmëhëna. Projektligji përmirëson dukshëm kuadrin e menaxhimit financiar të APU-së. Ai legjitimon modelin e financimit të arsimit parauniversitar publik, të mbështetur në formulën 'për nxënësi'. Në kuadër të kësaj logjike synohet arritja e transparencës së përdorimit të fondeve financiare dhe shtimit të përgjegjësisë së personelit shkollor në përdorimin e mirë të mjeteve dhe shërbimeve që sigurohen nga këto fonde".

Nëpërmjet këtij ligji parashikohet të përfshihet për herë të parë në skemën financiare, metoda e granteve për shkollat publike me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e cilësisë së shkollave. Në projektligj thuhet se një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm janë edhe përcaktimet që parashikon ligji për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, me qëllim mënjanimin dhe disfavorizimin e tyre në procesin e të nxënësve për shkak të aftësive fizike të kufizuara. Në të theksohet se çdo fëmijë në moshën 5- vjeçare duhet të vijojë në mënyrë të detyrueshme, së paku një vit arsim parashkollor, përpara regjistrimit në klasën e parë. Projektligji nxit zhvillimin e arsimit privat cilësor përmes vendosjes së standardeve të njëjta kurrikulare dhe të kualifikimit të mësimit në të publik. Rritjen e rolit mbikëqyrës të MASH dhe DAR/ZA ndaj politikave të personelit, drejtuesve dhe mësuesve, në shkollat private. Në projektligj i kushtohet rëndësi arsimit të pakicave kombëtare. Integrimi në familjen e madhe evropiane, kërkon plotësimin e standardeve dhe normat ndërkombëtare. E ardhmja e një vendi garantohet nëpërmjet një arsimit dhe edukimi sa më cilësor, për të gjithë grupet moshat, pa asnjë dallim, kulturor etnik fetar, social etj..



Projektligji “Mbi arsimin parauniversitar”; në shërbim të shkollës kombëtare.

Çdo shkollë në këtë rruzull është kombëtare dhe, bashkë me Sociologjinë, këtë vulë, me kapitull të veçantë për kombin, ia vënë e ia theksojnë edhe një serë lëndësh të tjera si Gjuha amtare, Letërsia, Historia, Gjeografia etj. Këto lëndë, vit pas viti shkollor, japin informacionin e nevojshëm, njëkohësisht, konsolidojnë edhe përkatësinë etnike, kombëtare, bëjnë, siç është thënë tradicionalisht, kultivimin dhe edukimin atdhetar. Tërë këto disiplina ekzekutohen në jetë nga një armatë mësuesish e pedagogësh, të cilët lënë edhe gjurmët e veta në klasë e auditor, sepse secili përcjell mesazhe edhe nga jeta e përvoja e vet.

Tekstet e çdo niveli shkolle kanë dhe dinamikën e tyre në përmbajtje, në metodikat dhe tërë aparatit pedagogjik, por gjithmonë ka vend për vështrim kritik, sepse përsosja e mësimdhënies është e pashtershme. Kjo është dhe më e evidente për shkollën tonë shqiptare, e cila, përveçse nuk ka ndonjë kohë të gjatë testimi, po vuan rëndë edhe copëtimin politik të kombit tonë në dy shtete shqiptare dhe me pjesë të konsiderueshme trojesh etnike e popullsie në katër shtetet fqinjë, pa lënë mënjane dhe diasporën tonë nëpër të gjitha kontinentet. Shkolla shqipe, sot, në sekullin e 21, përballet me disa sfida të realiteteve të reja, të cilat obligojnë institucionet zyrtare dhe shoqërinë civile të jenë përherë kërkues, kritik e krijues për t'iu përgjigjur dhe kualiteteve të reja të kohës. Ajo sfidohet nga gjendja e kombit ende të coptuar politikisht; nga “shkopinjte” që orvaten t'i vënë shqipes standarde, nga fantazitë e sëmura për shpikjen e një “kombi kosovar”; nga kërkesat e reja të integritimit evropian, pas daljes së vendit nga izolimi etj.

Sfidat angazhojnë dhe kanë vënë në lëvizje institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile. Shteti dhe shoqëria shqiptare i kanë tani të gjitha mundësitë dhe potencialet intelektuale e profesionale për përballimin e të gjitha sfidave, vetëm të punojmë me vullnet e përkushtim atdhetar, të mbajmë të pastër e t'i qëndrojmë besnik edhe parimit e kriterit kombëtar shqiptar. Sa më të kthjellët ta kemi identitetin, aq më të pranueshëm bëhemi për Evropën.

Projektligji “Mbi arsimin para-universitar”, me diskutimin publik të të cilit dhe nisi ky vit kalendarik për botën arsimore (Revista “Mësuesi” nr. 12, dhjetor 2010, botim i përdyjavshëm i MASH), me 94 nene, përbën një bazë të shëndoshë, horizonte e burim meditimi, sanksionon parime e norma që synojnë ta ngrenë arsimin tonë në nivelin e standardeve evropiane. Çështja është t'a përsosim këtë Projektligj, ta respektojmë dhe ta zbatojmë me këmbëngulje. Është me interes të theksojmë se kur shteti dhe shoqëria civile konvertojnë në synimet e tyre, ecja e punëve është e garantuar. Kështu vërejmë me kënaqësi se Projektligji në fjalë na vjen si një nxitje, inkurajim e mbështetje edhe për një nismë kulturore-atdhetare të një njësie të shoqërisë civile siç është Instituti i Integritimit të Kulturës Shqiptare.

Regjimi demokratik i ka lëshuar shumë frerin “lirisë akademike” saqë, brendapërbrenda Shqipërisë mund të gjesh në përdorim disa Abetare. I riu që vjen nga Prishtina, Tetova, Presheva, Ulqini a Gruda e Gucia për arsimim të lartë në Tiranë, ndeshet në disa vështirësi deri dhe të termave, nocioneve të ndryshme mbi një send a dukuri, që ka marrë brenda një shkollë shqipe. Mësuesit e shkollave shqipe në Maqedoni, brengosen kur programi dhe teksti mësimor i drejtimit human, u imponon të kumtojnë një realitet të cunguar apo dhe të shtrembëruar për çështjet shqiptare etj. Kombet kudo e përherë e kërkojnë organikisht shkollën e vet, sikurse dhe shkolla, nga ana e saj ka formësuar dhe mban gjallë kombin të cilit i përket.

Në këtë kontekst, Projektligji i përmendur, me të drejtë synon “përafrimin e programeve lëndore me ato të vendeve më të përparuar” të Evropës. Kjo është gjë shumë e mirë dhe e domosdoshme për ngritjen e nivelit arsimor brenda Republikës së Shqipërisë, por një angazhim i ynë, jo më pak i rëndësishëm, duhet të jetë edhe përafrimi i mundshëm brenda arsimit shqip në krejt hapësirat etnike dhe në diasporë, ku nuk janë të pakta dhe të vogla ndryshimet e divergimet, deri dhe në terminologjinë e përdorur.

A thua është e vështirë që për këto gjëra jetike të ketë një përqendrim, të punohet për një përafrim të mundshëm të termave, përkufizimeve dhe tërë përmbajtjes së temave që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar, me formësimin atdhetar të fëmijëve dhe të rinjve? Mos vallë slogani “një komb, një shkollë” është teprim dhe pretendim, sot në erën e demokracisë? Në këtë drejtim është lëvizur ngadalë dhe është bërë pak. Instituti i Integritimit të Kulturës Shqiptare, një OJQ joqeveritare dhe jofitimprurëse, që prej shtatorit 2010 ka ndërmarrë dhe po ndjek me grupe pune, hap pas hapi, Projektin me temë. “Studimi i mundësisë së përafrimit (deri në unifikim) të programeve dhe teksteve mësimore në trojet arbërore”.

Ky organizëm i shoqërisë civile është vënë në lëvizje në kohën e duhur, ka gjetur mbështetje e inkurajim deri nga titullarët e arsimit të Tiranës e Prishtinës. Konstatojmë se Projektligji në fjalë, me Nenin 25 se: “Ministria e Arsimit dhe Shkencës obligohet për bashkëpunim ... me organizma joqeveritare të vendit ose të huaja ... për zbatimin e projekteve të fushës e arsimit” * sanksionon çdo bashkëpunim të dobishëm, i jep mbështetje, inkurajim dhe krah nismës madhore në fjalë.

Në turneun me këtë mision fisnik nëpër viset amtare, në ministrinë e arsimit (Tiranë e Prishtinë), me drejtoritë rajonale në Tiranë dhe Durrës, në Tetovë, Shkup e Prishtinë e më tej, titullari i këtij Instituti (IIKSH) me bashkëpunëtorët e ngushtë, i ka ngritur grupet e punës, duke shpalosur dhe thelbin e Projektit se: “Ky studim është një domosdoshmëri, një imperativ që na e shtron koha imediatisht. Po bëjmë objekt studimi një nga hallkat kryesore të integritimit gjithë-shqiptar brenda trojeve të tyre, që do të shërbente dhe si një premisë drejt integritimit evropian. Në këtë aktivitet mendojmë se duhet të përfshihen një masë e madhe studiuesish, kryesisht nga fusha e arsimit, nga të gjitha trojet etnike: Shqipëria, Kosova, Çamëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës. Mbështetja nga armata e madhe e mësuesve të të gjitha kategorive të shkollave, vazhdimi i përvojës së tyre, dëgjimi i zërit të kësaj mase mësimdhënës, duke e amplifikuar këtë zë në çdo skaj arbëror, mendojmë se duhet kthyer në një lëvizje të organizuar kulturore, me bindjen dhe ndërgjegjësimin se këto synime janë themeli i afrimit dhe integritimit gjithë-shqiptar.

Ne po ndërmarrim një studim thjesht kulturor-shkencor, jashtë dhe larg çdo ndikimi politik apo dasie etnike. Obligimi ynë është të trajtojmë çështjet tona kombëtare, brenda normave dhe parimeve të demokracisë. Nuk kemi parasysh as bërjen identike të programeve e teksteve për të gjitha zonat ku jetojnë shqiptarët. Synojmë vetëm në përdorimin nga të gjithë të të njëjtave rregulla e norma drejtshkrimore të shqipes, në saktësimin shkencor të elementeve që përbëjnë thelbin e lëndëve shoqërore (gjuha e letërsia, gjeografia rajonale e historia kombëtare, sociologjia dhe cikli i edukatës qytetare); përdorimin e të njëjtës terminologji, programore, përfshi dhe shkencat natyrore për të evituar këndvështrimet e ndryshme dhe diversitetet e theksuara. Kemi bindjen se në këtë sipërmarrje vullnetare, nuk do të na mungojë edhe mbështetja zyrtare, por sidomos, ajo e intelektualëve krijues e kërkues!” Në festën e Abetares mund të shpërthesh artistikisht, por Abetarja e Gjuhës Shqipe duhet të jetë një, ajo më e mira, më gjurmëlënëseja. Njohuritë, informacioni shkencor, mund të ndryshojë në metodika e mjete ilustrimi, por formësimi atdhetar i nxënësve, shqiptaria, është një konstante, që duhet përcjellë po me atë kujdes që tregon nëna për fëmijën të sapo sjellë në jetë.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës - një kontribut i mundshëm i universiteteve tona

Prof. as. dr. Abdulla BALLHYSA

Dhjetëvjeçarin e fundit po haset gjithnjë e më shpesh dhe jemi pothuaj familjarizuar me terma të tillë si: “të mësuarit gjatë gjithë jetës” dhe “edukimi i të rriturve”. Kjo është mundësuar kryesisht nga materiale të ndryshme të ish - ISP-së, nga projekte të veçuara të OJF-ve etj. Pra, kryesisht përpjekje si sekuenca të veçuara dhe jo si program e plan i mirëstudiuar e i miratuar institucionalisht. Në Shqipëri, “gjallon” spontanisht “edukimi i të rriturve” dhe “të mësuarit e vazhduar”. Si shëmbëlltjërë e shtrembër e kësaj filozofie (tek ne) përmendim rastin e mësuesve pa arsim përkatës që ndjekin universitetin (dega mësuesi) për të ruajtur vendin e punës...Përvoja botërore në këtë fushë. Si mundet që fakultetet e mësuesisë (fillimisht ato dhe më pas edhe fakultetet e tjera) mund të kontribuojnë për hartimin dhe jetësimin e një programi të tillë? Kush mund të marrë pjesë në këtë program dhe si mund të zhvillohet ai? Si do të mund të zgjidhet në mënyrë institucionale zhvillimi i këtij projekti (fillimisht pilot) ku universitetet (fakultetet e mësuesisë) mund të jenë promotorët e tij?Vendi dhe roli (në të ardhmen) i DAR-ve, i MASH-it në këtë lloj edukimi të domosdoshëm etj.

Dhjetëvjeçarin e fundit në vendin tonë është shpeshuar edhe më tepër përdorimi i termave të tillë si: “të mësuarit gjatë gjithë jetës” dhe “edukimi i të rriturve”. Jo dhe aq keq, po të mendosh që në Evropën perëndimore ky term i ka fillimet e përdorimit në fund të viteve '60-të të shek. xx. Dhe, si çdo fillim i ri, edhe ne Evropë si kuptimi i termave të tillë, ashtu dhe përdorimi i tyre qenë sa spontanë aq dhe konfuzë.¹ Megjithatë, dora-dorës, termat “Të mësuarit permanent” (përkthe: Të mësuarit² gjatë gjithë jetës” dhe bashkë me të “Të mësuarit adult (të mësuarit e të rriturve) duhen konsideruar si shprehëse të një filozofie të re të edukimit, e cila diktohej nga kushtet që kalonte kontinenti në atë periudhë. Është mesi i viteve -90-të të shek. xx fillimi i jetësimin në Shqipëri i projekteve të para që mbështeteshin në këtë filozofi. Kjo është bërë e mundur kryesisht nga materiale të ndryshme të ish - ISP-së, nga projekte të veçuara të OJF-ve etj, sa për shembull, projektet e AEDP-së dhe të World Vision. Pra, kryesisht përpjekje “aty-këtu”, si copëza të veçuara të servirjeve nga edukatorë prej vendeve të ndryshme perëndimore kryesisht nga SHBA dhe, për më tepër, jo si program me plan të mirëstudiuar e të miratuar institucionalisht nga organet shtetërore përkatëse. Shkurt, ne pranoni çdo gjë që na servirej, pavarësisht se ato ishin arna në pallton e vjetër të trashëguar nga një tjetër lloj shkollë, një tjetër lloj sistemi edukimi e një

¹ “Faktivisht, edukimi i vazhdueshëm, si term, është përdorur si sinonim i edukimit të të rriturve(e ne vetë kemi bërë të njëjtin gabim)” rrëfen Bertrand Schwartz, “projekti Education permanent” 1969

² kur përmendim termin “të mësuarit” në këtë rast nënkuptojmë edhe të nxëniet. Pra e shohim, në këtë përdorim si një proces dykahësh. Personalisht jam kundër përdorimit të termave “procesi i mësimdhënies” dhe “i mësimnxënies”, që e ndeshim jo rrallë në ligjëratat dhe literaturën e kësaj fushë. Shqipja i ka tashmë dy terma të mirëkri- stalizuar qysh në kohën e Rilindjes: procesi “i të nxëniet” dhe procesi “i të mësuarit”.

tjetër lloj filozofie drejtuese.

Madje edhe sot, siç thotë populli: “s’i ngjan peri gëzofit”, gjendja vazhdon pak a shumë e njëjtë. Arnimet vazhdojnë dhe në të shumtat e rasteve na shërbehen si “reformë e si një filozofi e re edukimi”.

Edukimi gjatë gjithë jetës si “zgjdhje”...

Duket sikur shkruesi i këtyre radhëve është kundër jetësimin të kësaj filozofie të edukimit në vendin tonë.

Jo, kryekëput jo. Por askush që e njeh mirë gjendjen dhe nevojat e arsimit në vend, dhe, për më tepër, gjithkush që dëshiron ecjen përpara dhe modernizimin e sistemit arsimor në Shqipëri, nuk mund të pajtohet me atë që ka ndodhur dhe po ndodh dita -ditës në shkollën tonë kombëtare lidhur me çështjen që po rrekemi të trajtojmë.

Sot ne vendin tonë, “gjallon” spontanisht “edukimi i të rriturve” dhe “të mësuarit e vazhduar”.

Si shëmbëlltjërë e shtrembër e zbatimit të kësaj filozofie e praktike të edukimit (tek ne) mund të përmendim rastin e mësuesve pa arsim përkatës të cilët ndjekin universitetin (degët e mësuesisë) thjesht dhe të shtrënguar për të marrë një diplomë e cila i siguron ruajtjen e vendit të punës. Kënaqesh kur sheh parapensionistë që mbushin auditorët e universiteteve tona (fakulteteve të mësuesisë) mbasi të vete mendja se “të mësuarit gjatë gjithë jetës” është një praktikë e zakonshme në vendin tonë.³ Asgjë, pavarësisht se gjendja është krejt e ndryshme, përsëri ajo të shtyn të mendosh se universitetet kanë shumë për të bërë e dhënë në këtë hulli. Pra nevoja për të qenë të kualifikuar, e cila po paraqitet si domosdoshmëri edhe në vendin tonë, është një nga mundësitë dhe fushat ku universiteti mund të kontribuojë dhe, madje të kryejë funksion udhëheqës.

Për mendimin tonë edukimi i të rriturve, edukimi postdiploma është njëra nga mundësitë e rrugët që siguron “të mësuarit gjatë gjithë jetës”.

Nga ana tjetër, për mendimin tonë ka edhe rrugë të tjera që do ta siguronin këtë lloj edukimi. P.sh. duke parë nivelin e lartë të shtimit të sasisë dhe të cilësisë së informacionit që i shfaqet përpara njeriut të ditëve të sotme, duke marrë në konsideratë masën e madhe dhe shpejtësinë e “vjetrimin” të këtij informacioni, vetiu vjen shqetësimi se ç’duhet bërë në shkollë? Sa informacion duhet të marrë nxënësi i sotëm? Çfarë do të zgjedhë (nga gjithë kjo madhësi të dhënash) që t’i shërbejë për kohët që vijnë? A do të vazhdojmë ta mbushim kokën e tij me çdo gjë që na duket e rëndësishme sot, por që ndoshta nesër nuk do të vlejë më? Pra, a do ta konsiderojmë atë si magazinë dijesh apo si diçka tjetër? Këto dhe të tjera pyetje si këto qëndrojnë pezull përpara shoqërisë moderne e cila edukimin e anëtarëve të saj e realizon kryesisht nëpërmjet institucionit edukativ të shkollës. Pra, mos vallë për “të mësuarit permanent”, për “të mësuarit gjatë gjithë jetës” është e nevojshme një lloj “vaksine” që duhet bërë qysh në bankat e shkollës dhe më pas ajo ta sigurojë imunitetin nga sëmundje të tilla si “rehatia e padijesh”, apo nga siguria e “diplomës universitare”? Faktikisht këto lloj sëmundjesh nuk janë vetëm të shoqërisë shqiptare. Ato janë ndeshur dhe ndeshen sot edhe në vendet e zhvilluara dhe për këtë arsye përballemi përherë e më tepër me përpjekjet për krijimin e “shoqërisë së dijes” dhe të “bashkësive të të nxëniet”. Pasi, siç thotë Majkëll Fullan-i “Të nxëniet as nuk mund “të paktohet” në seminare të shkurtra dhe kurse ...”⁴ të ngritura shpejt e shpjet dhe sa për të kaluar radhën - do të shtonim ne. Në literaturën që trajton këtë çështje theksohet se “Përmbajtja

³ Kështu ishte përshtypja e disa pedagogëve të huaj kur panë këtë realitet në universitetin tonë.

⁴ M. Fullan “Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim”, Eidualba 2001, f. 396



e të nxënësve është e rëndësishme por nuk është më kryesorja...”⁵ për të pasur sukses në periudhën pas shkollore..

Rrugë të mundshme

Si mundet që fakultetet e mësuesisë (fillimisht ato dhe më pas edhe fakultetet e tjera) të mund të kontribuojnë për hartimin dhe jetësimin e një edukimi të tillë? Duke e parë problemin nga ky këndvështrim, siç edhe e përmendëm në fillim, fakultetet e mësuesisë (ato të parat) duhet ta shohin e ta trajtojnë këtë lloj edukimi në të dy kahet:

A. Në përgatitjen e mësuesve që do të edukojnë nxënësit e vegjël si qytetarë të ardhshëm të një shoqërie shumë të zhvilluar, apo që ecën e zhvillohet me ritme mjaft të shpejta, dhe
B. Në kthimin në “laboratorë a punishte” që ofrojnë mundësi edukimi edhe për ata që e kanë marrë një diplomë dhe që u duhet të bashkëkohëzohen në mënyrë të vazhdueshme formimin e tyre profesional, apo tërësor.

Theksoj këtu se duhet bërë dallim midis këtij lloj edukimi dhe trajnimeve që ofrojnë institucione apo OJF të ndryshme për mësuesit, kryesisht, apo edhe për ndonjë profesion tjetër, si mjekët, inxhinierët dhe specialistët e administratës shtetërore e private.

Edukimi fillestar si pjesë përbërëse e edukimit të vazhdueshëm e gjatë gjithë jetës. Nxënësit e vegjël si qytetarë të ardhshëm. Le t’u kthehemi edhe një herë pyetjeve që parashtrojmë në hyrje të trajtesës:

- Ç’ duhet bërë në shkollë?
- Sa informacion duhet të marrë nxënësi i sotëm?
- Çfarë do të zgjedhë (nga gjithë kjo madhësi të dhënash) që t’i shërbejë për kohërat që vijnë?
- A do të vazhdojmë ta mbushim kokën e tij me informacione që ndoshta nesër nuk do të kenë asnjë vlerë, apo do të kenë vlera relative?

A do ta konsiderojmë qytetarin e ardhshëm si depo njohurish të sistemuara pa kriter?

Përvoja botërore ka kohë që merret me këto çështje. Por edhe në vendin tonë, si rezultat i hapjes dhe i “ vërshimit” të

informacionit e përvojave të përbotshme një problem i tillë është në laboratorin përpunues e në tryezat vendimmarrëse të institucioneve përkatëse.

Duke mos dashur të ndalemi në këtë anë të problemit, le të përpiqemi të qartësojmë mendimin se si ta përgatisim qytetarin e ardhshëm si një nxënës të përhershëm, si një anëtar shoqërie që të nxënës të vazhdueshëm e ka domosdoshmëri, e ka përmasë të vlerave të tij jetësore.

A mund të përgatitet një i tillë qytetar qysh në bankat e shkollës? Si, në ç’ mënyrë? Cilat janë mjetet dhe rrugët për një të tillë formim?

Siç dihet ndryshimi i shpejtë dhe mjaft i vullshëm në shoqërinë e sotme globale, pjesë e së cilës është dhe kjo e jona, shfaqet si sfidë, që, për hir të vërtetës, i shkurajon ata që merren me edukimin dhe formimin e brezit të ri. Duket si një pengesë e pakapërcyeshme për edukatorët për hartuesit e kurrikulave për politikëbërësit e deri tek mësuesit e klasës në cepin më të largët. Si duhet t’i përgatisim fëmijët për të qenë sa më të suksesshëm në jetë, si mund të kenë mundësi ata të ndërtojnë një të ardhme më të begatë dhe më të frytshme, të ardhme të cilën nuk mund ta shohim, por vetëm mund ta imagjinojmë?

Askush nuk e di se ç’ lloj profesioni do të bëjnë nxënësit tanë të vegjël. Me këtë ndryshim të pamasë dhe të shpejtë asgjë nuk mund të parashikohet me vërtetësi. Por një gjë duket se dihet me siguri: dihet se do të kërkohen e nevojiten njohuri dhe mënyra arsyetimi të ndryshme në mënyrë që të funksionojnë dhe të jenë të frytshme, të suksesshme e dobiprurëse në botën e së ardhmes. Studiuesi Philips (Philips) (1992) shprehet se “ shumica e atyre që dimë sot, do të lihen mënjanë, përafërsisht për dhjetë vjet a më pak, përpara se t’u vijë radha të bëhen të përshtatshme...”⁶ “Shpërthimi” teknologjik ka sjellë për pasojë dhe “shpërthimin” e njohurive. Me anë të teknologjisë informatike libraritë e botës mundet të shfrytëzohen në çdo shtëpi. Kështu duket e paarsyeshme të mendosh për një lloj përzgjedhje paraprake nga “dikush”, nga një tekst apo një program.

Duket qesharake ideja se mund të na shpëtojë nga ky “hall” një tekst me një përmbajtje “të fortë” dhe që mund të plotësohet më vonë në vazhdim të jetës. Informacioni i drejtpërdrejtë që mund t’u japim fëmijëve në shkollë konsiderohet vetëm një pjesë mjaft e vogël e atij informacioni që ata nevojitet të dinë , e që ta përdorin si të suksesshëm në vitet e ardhme.

Kështu dijetarët që merren me këto probleme kanë dalë në përfundimin se më e suksesshme do të jetë ajo shkollë (nënkupto, sistem e filozofi) që do t’u mësojë nxënësve se si të nxënë në mënyrë frytdhënëse (produktive) dhe të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese. Fëmijët (nxënësit e qysh në moshë të vogël) duhet të aftësohen që ta nxjerrin vetë informacionin e ri, ta shqyrtojnë atë në mënyrë të kuptimshme dhe kritike. Dobiplotë për nxënësit, qytetarë të shoqërisë të së ardhmes, është mësimi dhe pajisja me shprehitë e të shqyrtuarit vetjak e të pavarur të informacionit, e nxjerrjes së ideve dhe e veprimit në përputhje me këtë lloj të të menduari. Duke i shqyrtuar idetë e reja në mënyrë skeptike dhe nga këndvështrime të ndryshme, duke gjykuar mençurisht mbi vërtetësinë dhe vlerën, duke i parë këto në mënyrë të lidhur me nevojat dhe qëllimet, vetëm atëherë do të kemi mundësi të jemi të suksesshëm në një shoqëri që përparon me hapa galopantë. Një shkollë e suksesshme, një filozofi e tillë, do të mund të konsiderohej ajo që përgatit nxënësit me të tilla aftësi dhe shprehje. Psikologu amerikan Albert Bandura (1995, f. 34) e përmbledh kështu rolin e ri të shkollës: Në realitetet e reja janë të nevojshme kompetenca konjitive vetërregulluese për të mbuluar detyra komplekse dhe për të përballuar kërkesa nga më të ndryshmet të jetës bashkëkohore. [...] Një prej objektivave themelore të edukimit (formimit të nxënësve, shënimi im A.B.) është ai i pajisjes së nxënësve me mjete intelektuale, me bindje e vetëbesimin, me motivimin e duhur për të vazhduar edukimin e vetvetes përgjatë gjithë jetës.⁷

⁵ Jeannie L. Steele, Kurtis S. Meredith & Charles Temple, Zhvillimi i mendimit kritik, “ Shpërthimi i njohurive”, Udhëzues Nr 2, Tiranë, Lilo 2000, f. 15

⁶ Po aty, Zhvillimi i mendimit kritik, f.14

⁷ Giovana Boda & francesca Mosiello, “Life skills”, Carocci editore, Roma 2005, f. 9

Gjuha amtare, vlerë dhe detyrë për gjithësecilin

“Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij” (Eqerem Çabej)

MA. Joana KOSHO
Pedagoge gazetarie

Ky shkrim merr nismë nga një diskutim i përhapur në media dhe në qarqe akademike, mbi mënyrën sesi po trajtohet gjuha shqipe në sistemin parauniversitar. Gjenezja e të mësuarit të gjuhës amtare, përveçse në familje, fillon të rrënjohet në shkollën fillore e nëntëvjeçare, si dhe ushqehet dhe lëmohej gjatë shkollës së mesme. Boshllëqet, mangësitë dhe pamjaftueshmëritë që një nxënës mund të trashëgojë nga shkolla parauniversitare, i shfaq pa i korrigjuar gjatë universitetit dhe i dëshmon papërgjegjshmërisht gjatë gjithë jetës së tij. Studentët e gazetarisë, të cilëve u jap leksion, që duhet të dinë të “luajnë” me fjalën (pra ta njohin dhe ta përdorin mirë atë), shpesh dëshmojnë mangësi të theksuara njohurish, duke mos qenë të aftë të shprehin dhe të shkruajnë në mënyrë korrekte.

Mësimi dhe përdorimi korrekt i gjuhës amtare ka një rëndësi të veçantë. Përmes përvetësimit të saj krijohen dhe transmetohen nocionet dhe mesazhet, të cilat janë çelësat për kuptimin e vetvetes dhe të botës. Gjuha amtare është mjeti më i rëndësishëm për realizimin e kuptimit dhe të bashkëpunimit. Saktësia, frytshmëria, si dhe arritja e tyre varen drejtpërdrejt nga mundësitë dhe njohuritë për gjuhën. Qëllimi i mësimit të gjuhës shqipe është përvetësimi në një nivel maksimalisht të lartë i të katër shprehive komunikuese gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, si dhe i aftësisë dhe i formimit gjuhësor, kulturor, etik, shpirtëror i brezit të ri, si domosdoshmëri për të ardhmen e kombit tonë.

Duke gjykuar mbi këtë fenomen, zanafilla e problemit të çon pikërisht aty ku ngjizen njohuritë, në arsimin parauniversitar, aty ku i duhet dhënë rëndësi maksimale mësimit të gjuhës shqipe, duke mos lënë prapa dhe letërsinë apo disiplina të tjera me bazë komunikimin. Por pikërisht në vatrën e dijes, në shkollat nëntëvjeçare, aplikimi i një formati të ri përsa i përket leximit dhe gjuhës shqipe, përveç arritjeve, ka derivuar dhe rezultate të padëshiruara. Leximi (letërsia) dhe gjuha janë shkrirë në një lëndë të vetme dhe kjo ka krijuar sfida të reja për mësuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të gjimnazit, por edhe për vetë nxënësit, të cilët i marrin njohuritë të ndërthurura dhe të shkrira tek njëra-tjetra, duke mos u thelluar në njohuritë e secilës lëndë. Pjesët në lexim tashmë nuk jepen vetëm për hir të një komenti letrar, por edhe për t'i parë nga ana gjuhësore. Në thelb, kjo shkrirje synon t'u japë nxënësve një kulturë gjuhësore, duke mos e parë më atë ngushtësisht si qëllim në vetvete, por për ta

vënë në funksion të aspektit letrar. Këto njohuri të integruara gjuhë dhe lexim synojnë të njëjtën gjë: ta bëjnë nxënësin një përdorues të mirë të mjeteve gjuhësore e të ndërgjegjësojë që të çmojë këtë pasuri si mjet komunikimi dhe krijimtarië. Pra ideja për të shkrirë gjuhën me letërsinë, bazohet në parimin që duke zberthyer sistemin gjuhësor të lehtësohet të kuptuarit e letërsisë. Por sa është realizuar deri tani qëllimi i programeve të reja të gjuhës dhe letërsisë? A është metoda më e mirë për t'u aplikuar, kjo e shkrirjes së gjuhës me letërsinë, si në shkollën nëntëvjeçare dhe në të mesmen?

Në lidhje me këtë çështje, studjues, profesorë e pedagogë shprehin të shqetësuar për trajtimin që i bëhet gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar. Në një intervistë dhënë për gazetën Telegraf (shtator 2010), profesor Xhevat Lloshi, nënvizon rëndësinë e gjuhës shqipe në shkollat nëntëvjeçare, duke kërkuar që njohuritë mos përsëriten në shkollën e mesme, por t'i jepet më shumë rëndësi komunikimit dhe sistemeve stilistike të gjuhës. Sipas Prof. Lloshit shkrirja në një tekst e gjuhës me letërsinë nuk është një ide e mirë. “Ideja se ne duhet t'u mësojmë letërsinë dhe gjuhën që fëmijët në 9-vjeçare të përgatiten për shkrimtarë dhe poetë është krejtësisht e gabuar. Ideja e shkrirjes së gjuhës me letërsinë na kalon në shkollën e mesme. Mendoj se këtu ka nevojë të rishikohet struktura themelore e lëndës së shqipes në këto shkolla dhe duhet të jetë gjuhë jo e shkrirë me letërsinë.”, shprehet profesor Xhevat Lloshi.

Përfshirja e gjuhës shqipe dhe në shkollë të mesme, konsiderohet vërtet si një arritje, por mënyra e konceptimit të saj, jo si një lëndë e veçantë, por e bashkëngjitur me letërsinë dhe aplikimi i kësaj metode në të gjithë sistemin parauniversitar, ka krijuar shumë shtigje të reja debatesh dhe pakënaqësish. Megjithatë, aty ku ka debat, apo diskutim, ka ide; dhe aty ku ka ide, besoj se ka zgjidhje. Ndaj është mirë që problemet të mos anashkalohen, por të identifikohen, të debatohen dhe të zgjidhen.

Disa nga problemet e programeve dhe teksteve të gjuhës e letërsisë janë identifikuar në një analizë që profesor Ali Jashari ka botuar në gazetën Shqip (prill 2010). Sipas profesor Jasharit, “... në programet dhe tekstet shkollore ka një prirje për të dhënë sa më shumë njohuri teorike. Mbushullia e termave gjuhësorë është kaq e madhe, sa nxë-



BURSA STUDIIMI NGA QEVERIA HUNGAREZE

Ambasada Hungareze në Tiranë njofton se qeveria e Republikës së Hungarisë ka shpallur programin e bursave për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet universitare, pasuniversitare, në fushën e kërkimit, si dhe në kurse vere pranë Universiteteve Publike të Hungarisë, për vitin shkollor 2011-2012, sipas kategorive të ndara si më poshtë.

nësve u mbushet koka me gjëra të vështira, të përsëritura gjithandej, të pasqaruara si duhet për moshën e tyre, një dukuri kjo që buron nga fakti se njohuritë teorike janë marrë “en bloc” nga librat e nivelit akademik e universitar dhe janë futur në tekstet për nxënësit e shkollës nëntëvjeçare”. Në analizën e tij kritike, profesor Jashari rendit arsyet, që sipas tij, gjuha shqipe duhet studjuar si disiplinë e veçantë në shkollën e mesme:

E para, sepse nxënësit që mbarojnë shkollën nëntëvjeçare nuk e kanë kulturën gjuhësore të mjaftueshme, çka është e domosdoshme për çdo qytetar. Së dyti, shumë koncepte e dukuri gjuhësore fëmijët nuk mund t'i rrokjin në shkollën nëntëvjeçare, për shkak të moshës së njomë, të shkallës së zhvillimit intelektual etj. Arsyeja e tretë bazohet tek argumenti se prirja e madhe e njerëzve për të mësuar gjuhë të huaja, duhet të mbështetet në një bazë të fortë njohurish për gjuhën shqipe. Gjithashtu, mjedisi i sotëm gjuhësor publik shoqëror, familjar etj., në shumë raste, [...] nuk ndikojnë sa duhet për rritjen e kujdesit për gjuhën amtare, madje, siç dihet, ushtrojnë një trysni në dëm të gjuhës standarde shqipe dhe të përvetësimit të saj të frytshëm nga nxënësit. Dhe së fundi, në shume vende të zhvilluara të botës, gjuha amtare studiohet në disa nivele, deri në moshën e mesme shkollore e më tej dhe zë “bashin” e vendit në programet shkollore.

Pedagogë dhe gjuhëtarë të tjerë, pozicionohen pro shkrirjes së gjuhës me letërsinë. Problemin ata e shohin tek aftësia e mësuesve, kryesisht atyre të shkollës nëntëvjeçare, për ta shtjelluar dhe shpjeguar lëndën. Gjatë bisedave me mësues të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, konstatojnë se ata janë të shqetësuar për efektivitetin dhe dobishmërinë e kësaj mënyre të re për të shpjeguar gjuhën dhe leximin. Tekstet janë të ngarkuara me shumë terma, koncepte dhe njohuri (si p.sh. brainstorming, etj), të cilat jo gjithmonë janë të përshtatshme për fëmijë të shkollës nëntëvjeçare. Vështirësisë që derivon nga bashkimi i gjuhës me letërsinë në një tekst të vetëm, i shtohen dhe kërkesa të ndërlikuara mësimore (si p.sh. nxënësi i nëntëvjeçares të mësojë shkrim akademik, të bëjë një ese, etj). Edhe pse ora mësimore ndërtohet sipas një metode efçente - me në qendër nxënësin, sipas të cilës mësuesi nuk prezanton në mënyrë formale mësimin e ri por e shpjegon literaturën duke ndërvepruar me nxënësin, fëmijët bombardohen me informacion të parakohshëm për formimin e tyre. Edhe në shkollën e mesme, nxënësit marrin njohuri shumë të profilizuara (si p.sh. mësojnë kriteret e shkrimit gazetaresk, kryeartikujt, pyetjet e famshme 5W dhe 1H, etj), duke shfokusuar vëmendjen nga njohuritë themelore bazike që duhet të merren dhe asimilohen në gjimnaz dhe duke u orientuar në disiplina dhe lëndë të cilat, nxënësit mund t'i marrin gjatë ciklit universitar.

Përderisa ekziston një debat mbi programet dhe tekstet e gjuhës amtare - një diskutim që akoma nuk është shuar - atëherë kjo tregon se problemet akoma nuk kanë marrë zgjidhje. Vëmendja nuk duhet larguar nga kërkesat specifike që ka sistemi parauniversitar, aq më shumë kur bëhet fjalë për gjuhën shqipe, sepse pasojat negative të këtyre shqetësimeve do bëhen gjithnjë e më të mëdha. Si pedagogë gazetarie, nuk do doja t'i tërhiqja vëmendjen studentëve për probleme drejtshkrimi, apo sintakse, por të diskutoj apo kritikoj mbi çështjet e profesionit. Ky debat duhet të gjejë zgjidhje për të mos precipituar në realitetin e hidhur të cënimit dhe nënvlerësimit të gjuhës amtare.

A - Studime të pjesshme në nivelin Bachelor dhe Master (3-10 muaj)

Për këto bursa mund të aplikojnë studentë të nivelit parë (Bachelor) ose studentë të nivelit të dytë (Master) për programe të ndryshme studimi. Për bursat A preferohen studentë të fushave: gjuhë dhe të letërsi hungareze, mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmakologji, veterinar, arkitekturë dhe drejtësi. Kërkohej që kandidatët e interesuar të kenë përfunduar të paktën 2 semestra në institucionet e arsimit të lartë të vendit të tyre. Moshë e pranimit është deri 30 vjeç.

B - Studime pasuniversitare ose në fushën e kërkimit (3-21 ditë ose 1-10 muaj)

Të gjithë të interesuarit për këtë kategori bursash duhet të jenë të pajisur me një diplomë të nivelit Master. Gjithashtu, aplikantët që vazhdojnë studimet, rekomandohen në programin e Doktoraturës, por që dëshirojnë të kryejnë kërkime për tezën e studimit në PhD. Studentët që përfshihen në këtë nivel studimi, nuk përfitojnë kredite. Moshë e pranimit është deri në 40 vjeç.

C/1 - Studime në Doktoraturë (PHD,) program i plotë (36 muaj)

Për këtë lloj programi mund të aplikojnë vetëm studentë që zotërojnë gjuhën hungareze. Bursa jepet me kusht për ata kandidatë që i nënshtrohen provimit para pranimit në universitet për programin PhD. Moshë e pranimit është deri në 35 vjeç.

C/2 - Studime në Doktoraturë (PHD), program i pjesshëm 1-12 muaj

Për këto bursa mund të aplikojnë vetëm ata studentë që janë të regjistruar për programin e doktoraturës në universitete të akredituara të vendit të tyre, ose në një vend tjetër të huaj, por jo në Hungari. Aplikantët nuk duhet të jenë më shumë se 35 vjeç.

D - Studime në postdoktoraturë dhe në fushën e kërkimit (1-10 muaj)

Aplikantët duhet të kenë titullin Doktor ose një gradë të barazvlefshme. Aplikantët duhet të jenë deri në 45 vjeç.

E - Vizita Kërkimore (3-21 ditë, ose 1-10 muaj)

Aplikantët duhet të jenë asistentë profesorë, profesorë ose kërkues të nivelit të lartë dhe të kenë minimalisht titullin “Doktor i Shkencave”.

F - Kurse Vere (1-4 javë)

Lista e kurseve që mbulohen me bursë gjendet në faqen www.scholarship.hu

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve për këto bursa është data 15 Prill 2011. Për një informacion më të hollësishëm për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni adresës www.scholarship.hu

Dy kopje të dokumentacionit përkatës duhet të dërgohen me postë në adresën e poshtëshënuar:

**Balassi Intézet, MÖB Iroda
1519 Budapest, Pf. 385
HUNGARY**

Kujdes! Pranohen vetëm ato aplikime që dërgohen me postë dhe në formë elektronike.

SEKTORI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Globalizmi në Arsimin e Lartë

Fjala “globalizim” intrigon menjëherë imazhe politike ndërkombëtare, kompani e koncerne shumëkombësh me aktivitet në të gjithë globin, teknologji të komunikimit apo shkatërrimit në distancë, etj. Kjo të kujton madje dhe konsiderata të tilla si Samuel Huntington i cili në librin e tij “Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e Rendit Botëror” i sheh qeveritë kombëtare si relike dhe se i “vetmi funksion i dobishëm i tyre është të facilitojë operacionet e elitës globale”. Persona të tillë si Bill Gates, Rupert Murdoch, Lloyd Blankfein, etj konsiderohen si kampionë të proceseve globalizuese.

Dhimitër BAKO/MASH

Deklarata e Bolonjës bën thirrje për ndërkombëtarizimin e aktiviteteve të institucioneve evropiane të arsimit të lartë. Ky do të jetë dhe tipari kryesor i Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë që kërkohet të krijohet në këtë kuadër. Dhe mjaft akte të tjerë të BE kanë për synim të njëjtën gjë.

Programi TEMPUS nxit institucionet e Vendeve Anëtare të BE dhe vendeve partnere të përfshihen në bashkëpunimin e strukturuar përmes ngritjes së “konsorciumeve”. Duke dalë jashtë Bashkimit Evropian, si shembull, mund të sillen përpjekjet e universiteteve më në zë në botë që kërkojnë krijimin e aleancave me institucione homologë kryesore kinezë. Një numër në rritje vendesh po përpiqen të krijojnë një grup elitare të universiteteve globale, të aftë të konkurrojnë me universitetet më të mirë amerikanë. Kina dhe India po fokusohen në një grup të vogël universitetesh. Qeveritë franceze dhe gjermane, në luftë me barazimtarët akademikë, po mendojnë e veprojnë për krijimin e Ligës Evropiane të Dredhës (European Ivy League). Mbas këtyre përpjekjeve qëndron ideja se universitetet e klasit botëror mund të bëjnë një shpërndarje të re të rritjes ekonomike.

Baza teorike e këtyre realiteteve qëndron kryesisht në veprimin e ligjeve të avantazhit të krahasuar dhe të ekonomisë së shkallës. Por shpesh neglizhohet roli i vërtetë i një faktori tjetër globalizues: universitetet. Për disa studiues universitetet, historikisht, janë institucionet e para globale. Në bazë të shpjegimit të fenomenit qëndron pranimi **së pari** i rolit të dijes si një e mirë publike (nuk ka monopol mbi të dhe si pronë e njerëzimit nga një zbulim të ri përfitojnë të gjithë).

Së dyti, që sfidat e kohës duhet të përballohen globalisht. Përhapja dhe zotërimi globalisht i dijes është mjeti më efektiv në këtë përballje. Në ndihmë të saj vijnë mjetet e rrjetet e komunikimit dhe të përhapjes së dijes të cilët po sofistikohen me shpejtësi marramendëse.

Së treti, mundësisë së ndërhyrjeve efektive, në raportin kërkesë / ofertë, në tregun global të arsimit të lartë. Nga sektori publik dhe nga nismat e ndryshme private.

Globalizmi universitar paraqet disa karakteristika (megjithëse nuk kufizohet vetëm në to):

A. Zgjerimi gjeografik i kampuseve të universitare, hapja e filialeve në vende të tjera. Kjo në përgjigje të kërkesës në rritje për arsim të lartë në vendet në zhvillim dhe veçanërisht tek ato me boom ekonomik (polet e reja të zhvillimit në botë). Madje ka edhe studiues që mendojnë se, aktualisht, kjo për universitetet elitare paraqitet si një sfidë globale dhe një përpjekje për mbijetesë e sigurim të cilësisë.

Hapja e një filiali të Universitetit amerikan Johns Hopkins në Itali në vitin 1955 dhe në Kinë në vitin 1986 (dhe për më tepër në gjuhën angleze), shënoi lajm. Ndërsa aktualisht universitete amerikane me filiale të tyre numërohen deri në 78, madje katër prej tyre në Britani. Universitete australiane kanë një prezencë të dukshme jashtë me filialet e tyre në Malajzi, Singapor, Emiratet e Bashkuara Arabe. Gjashtë universitete amerikane kanë hapur një lloj supermarketi të arsimit të lartë në Katar.

B. Krijim dhe arranjime partneriteti e aleancash në nivel ndërkombëtar. Universitetet po krijojnë dhe zgjerojnë vazhdimisht platforma të ndryshme bashkëpunimi.

C. Mobiliteti në rritje i studentëve, stafeve akademikë e kërkuesve shkencorë. Në nivel global gjithnjë e më shumë po rriten kërkesat për studime jashtë vendit, duke kërkuar studime në universitete me reputacion botëror. Lëvizja e studentëve dhe kërkuesve vihet re që me themelimin e universiteteve të parë në shek XII (kujtojmë këtu referenca që i bëhet shpesh studentit të parë të njohur zyrtarisht, që ka studiuar në një universitet jashtë vendit të tij të lindjes - shkencëtari Emo nga Friesland (Hollandë) i cili në vitin 1190 shkoi për të studiuar në Oksford). Por, nga një përjashtim ose sporadik, ky fenomen është kthyer në një dimension mjaft dinamik tw tregut të arsimit dhe që po dominon në veprimtarinë e politikave të arsimit të lartë. Mund të përmendim si shembull par excellence politikave të nxitëse të Bashkimit Evropian në drejtim të mobilitetit të studentëve, pedagogëve e kërkuesve. Në shërbim të këtij mobiliteti bëjnë pjesë dhe përpjekjet për njohjen e kualifikimeve akademikë e profesionalë (shëmbull Korniza Evropiane e Kualifikimeve).

Nxjtja e mobilitetit të studentëve është një nga dimensionet e veprimtarive të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë të lançar në kuadrin e procesit të Bolonjës. Tanimë rreth 90 % e universiteteve evropiane në 31 vende marrin pjesë në programin Erasmus Që me lançimin e tij në 1987, ky program ka qenë mjaft i suksesshëm. Vetëm në vitet 2008-09 Erasmus ndihmoi rreth 200 000 studentë të studjojnë jashtë vendit të tyre.

Vendimi i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE i datës 16 Dhjetor 2008 krijoi Programin Erasmus Mundus 2009 - 2013 për forcimin cilësisë në Arsimin e Lartë dhe promovimin e mirëkuptimit kulturor përmes bashkëpunimit me vendet e treta. Mendohet se ky Program do të rrisë ndjeshëm atraktivitetin e universiteteve evropiane në botë.

Në literaturën që trajton këtë problem mobiliteti shihet edhe me syrin praktik e përfitues. Vihet në dukje se zënia e hapësirave të tregut për studentë, akademikë e kërkues po kthehet në një obsesion. Universitetet në këtë garë po përpiqen të tërheqin sa më shumë nga vendet e tjera.

Mobiliteti paraqitet mjaft dinamik në treguesit në rritje të tij. Në 1980 mbi 1 milion studentë ishin regjistruar në universitete jashtë vendit të tyre të origjinës. Në vitin 2000 kjo shifër arriti në 2 milion dhe numri shkoi në 3 milion në vitin 2008.

Mjaft universitete po përdorin një stratagjemë interesante për të tërhequr studentë. Meqenëse gjuha angleze është shndërruar në lingua franca e biznesit, shkencës dhe deridiku e kulturës së sotme në shumë universitete ofrohen programe e kurse studimi në këtë gjuhë, gjë që ka rezultuar e suksesshme. (p. sh. disa vende të BE, Japonia, etj).

Ardhja e studentëve nga jashtë ka një impakt të caktuar në jetën e universiteteve dhe të vendit pritës. Në Britaninë e Madhe me të ardhurat prej 25.4 miliard sterlina, arsimit lartë krahasohet si një industri e krahasueshme me industrinë e botimeve, që kalon disi industrinë e reklamave dhe shumë më e madhe se industria e aeroplanëve, e mjeteve hapësinore ose ajo farmaceutike. Më shumë se 10% (2.9 miliardë paund) e këtyre të ardhurave vijnë nga burime të huaja. Pa llogaritur 2.3 miliardë të shpenzuar nga këta studentë për akomodim, ushqim, pije dhe zbatimje. Përfitimi nga këto të ardhura shtrihet e edhe më tej duke patur parasysh se plotësojnë shkurtimet në buxhet për arsim ose nevojat në rritje për shpenzime të universiteteve që nuk mund të mbulohen nga grantet e ndihmat shtetërore për arsye të ndryshme. Në këtë kuadër vihet re krijimi i një rrethi virtuoz: universitetet e financuara mirë kanë mundësi më të mëdha për rekrutimin e pedagogëve e profesorëve më të mirë dhe pajisjen me laboratorë më modernë. Si të tillë i rrisin më tepër të ardhurat.

Studiuesit vënë re, përveç përfitimeve ekonomike, edhe një numër arsyesh të tjera në këtë garë në tregun e studentëve. Akoma më praktike. Përballë rritjes së dembelizmit të studentëve vendas pozicionohet zelli i studentëve të huaj (sidomos nga Azia) që i mban lart standardet. Kjo i bën të ndërgjegjshëm të parët se këta të fundit janë konkurrentët e vërtetë të tyre. Një arsye tjetër që evidentohet është dhënia e një arome ndërkombëtare kampuseve universitare. Vihet re se studentët e huaj në vend që të integrohen në jetën e vendit të ri ata rrojnë të grupuar sipas kulturës që bartin duke formuar një kulture ndërkombëtare brenda këtyre institucioneve. Kjo bën të mundur që kjo kulturë të mbijetojë e të bëhet e kontaktueshme në vendet që ofrojnë arsim të lartë. Një problem i tillë konsiderohet mjaft familiar në Shkollën Londineze të Ekonomiksit ku gjysma e studentëve universitarë dhe 80% e atyre pasuniversitarë janë të huaj.

Në një këndvështrim tjetër shihet se n.q.s nuk rijnë në vendet pritës (si tru ekselent) shihet si krijim i një kontingjenti me formimin e duhur përëndimor në vendet ku shkojnë. Me ta është më lehtë të punohet si partnerë në vendet e tyre të origjinës.

Globalizimi akademik po shndërrohet në një dimension gjithnjë e më i pranishëm të veprimtarive në universitetet e sotme. Kjo ka një precedent. Bëhet fjalë për traditën e Universiteteve të Parisit dhe të Bolonjës të cilët në mesjetë ishin mjaft tërheqës për shkencëtarët "endacakë" nga e gjithë Evropa. Në shek. XIX universitetet kërkimorë gjermanë tërhiqnin shkencëtarë nga e gjithë bota. Në fillim të shek. XX filantropë si Cecil Rhodes dhe William Harkness krijuan sisteme bursash që çuan në forcimin e lidhjeve akademike ndërmjet kombeve. Madje në vitet '60 të shekullit të kaluar kaq të përhapur ishte fenomeni i profesorëve "lëvizës" sa që u bënë dhe objekt i anekdotave të ndryshme si: cili është ndryshimi ndërmjet Zotit dhe profesorit "filan"? Zoti është kudo ndërsa profesori është kudo përveç se këtu.

Aktualisht, TEMPUS ofron grante të mobiliteteit individual duke ndihmuar personat të angazhuar në sektorin e Arsimit të Lartë të ushtrojnë veprimtari të caktuara në vende të tjera.

Një nga funksionet/pasojat e mobilitetit është forcimi i kapaciteteve organizatave dhe individuale në për-

ballimin e sfidave lokale dhe globale. Ky mobilitet akademik shfrytëzon potencialet, shmang kufizimet ndaj kërkuesve dhe zgjeron lirinë akademike.

Bashkëpunimi ndërmjet stafit pedagogjik e kërkimor të vendeve të ndryshme tashmë është një fenomen krejt i zakonshëm. Po kështu kërkuesit sabatikë gjithnjë e më tepër kërkojnë të realizojnë studimet e kërkimet e tyre jashtë vendit të tyre. Madje, studiues thonë se globalizmi nuk është thjesht bashkëpunim kërkimor e shkencor ndërkufitar të kryera me dietat e institucioneve apo projekteve të ndryshme ndërkombëtare.

D. Dinamizmi i raportit ndërmjet vendeve ofrues / konsumatorë të arsimit global. Tiparet që karakterizojnë tregun e arsimit janë ato të një tregu të vërtetë. Ndër të tjera mund të përmendim:

Mjedis konkurrues i shprehur në garën për studentë, rekrutimin e trurit dhe të talenteve akademike. Kjo sidomos përbën një tipar dallues për vendet që kërkojnë të ngrenë ekonomi të mbështetur në dije shkencore. Si shembull mund të sjellim politikatat e BE në kuadrin e Procesit të Lisbonës.

Ranking i universiteteve i cili kryhet rregullisht me qëllim evidentimin e të dhënave në këtë treg global. Informacioni kërkohet me qëllim funksionimin efektiv të tregut. Krijimi gradual i një meritokracie akademike (që mendohet të ketë pasoja afatgjata pozitive).

Dinamizmi i tregut shfaqet edhe në lëvizjen e qendrave gravitacionale. Për ilustrim: në fund të shekullit të XIX amerikanët, për shkollimin e tyre iu drejtuan universiteteve gjermane, duke u mundur ta transplantojnë këtë model në SHBA. Ndërsa aktualisht janë gjermanët ata që po kopjojnë modelet e universiteteve amerikanë me qëllim krijimin e grupi elitar institucionesh të arsimit të lartë të nivelit botëror. Vende te tilla që konsumonin arsimin ndërkombëtar tani po shndërrohen në ofrues të tij p. sh. Singapori dhe Malajzia.

Madje, vihen re edhe tiparet negative të tregut, siç është ajo e krijimit të një "proteksionizmi akademik". P. sh. India e ka të ndaluar me ligj ngritjen e filialeve të huaja në vend (megjithëse edhe këtu diçka po ndryshon).

Për faktin se jo të gjithë filialet në vendet e tjera ngrihen me qëllime të sinqerta, tregu akademik ka ngritur nevojën e rishikimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator të tij me qëllim që përfituesit e këtij shërbimi të kenë një terren me rregulla të qarta loje e informacion të mjaftueshëm. Krahas këtyre karakteristikave, nga studiuesit, evidentohen edhe të tjera si dinamizmi i të mësuarit në distancë, ndërkombëtarizimi i partneritetit publik - privat, etj që do të jenë objekt i shkrimeve të tjera.



Reportazh nga dy shkolla të Kryeqytetit

Nga Sajmira DHOSKA - studente e gazetarisë

Rrugën për në shkollën e mesme të “Hoteleri Turizmit”, në kryeqytet, e bëme së bashku me shkrimtarin Andon Andoni dhe piktorin Zaim Elezi duke mbartur me vete edhe aparatet e fotografimit dhe diktofonat.

Kishim biseduar paraprakisht me drejtoreshën e shkollës zonjën Flutura Vaqarin se do të shkonim për një reportazh dhe ata kishin përgatitur një ditë të veçantë për ne. Si studente gazetare jo fort me përvojë, edhe unë provoja emocionet e shkollës.

Shkolla ishte e “qetë” në pamjen e saj të parë, me vetëm dy tri nxënës në oborrin e saj dhe sapo kalojmë pragun, një mori nxënësish të veshur me rrobet e profesionit, recepsionistë, na pritën me një përkujdesje të përkorë.

Mirëseardhje më të këndshme se kjo nuk mund të gjenim madje as fjalë për këtë shkollë të veçantë në llojin e saj në mbarë vendin. Korridorët dhe mjediset e brendshme, sipas epitetit të parë, të njërit prej, nesh, “si në spital” ishin më se domethënëse për një mjedis ku shpaloset kulturë sjelljeje dhe dije e fituar për jetën.

Në kuzhinë.

Ishte gati mesditë dhe ne qëlluam të mbërrinim tek “Hoteleri Turizmi” bash kur një nga klasat e dhjeta të shkollës ushtronte, apo më saktë ushtrohej në orën mësimore të kuzhinës. Një mjedis i vogël brenda shkollës, por tërësisht i kompletuar me pajisjet më moderne dhe të mjaftueshme të kuzhinës,

-Janë që të gjitha të ardhura nga Austria përmes bashkëpunimeve të frytshme me shkollat të arsimit profesional atje,- tregon drejtoreshë Flutura.

Ndoshta nuk na mjafton ky mjedis, sepse përllogaritjet janë bërë për një ambient tjetër jashtë shkollës....Dukej se këtë por, do të na e sqaronin më vonë. Në fakt fotot tona ilustruese, që po botojmë në faqen e revistës, me djem e vajza të rregullt, të pastër si drita, flasin më shumë se fjalët.

Të heshtur, sikush në detyrën e vet, me pjatancën e karotave të grira mjeshtërisht dhe me përkushtimin ndaj kohës për të qenë perfekt në menynë e gatimit për këtë orë mësimi, të bëjnë të ndjehesh entuziazt.

Dhe me të vërtetë, pas fjalëve të drejtoreshë Fluturës që na shoqëron, jo pa krenarinë e ligjshme për sa ka arritur të ngrehë në këtë shkollë me mundin e përkushtimit e saj dhe të gjithë trupës mësimore, ndjekim dhe “vërejtjet” e mësues specialiste të kësaj lende, Mukades Memojdinit. Mjafton një tundje koke, një vështrim disi i vëngërt që nxënësi të korrigjojë me të shpejtë mënyrën e mbajtjes së thikës, sasinë e konjakut që duhet të hidhte mbi tiganin e nderur flakë, e të tjera detaje si këto që të kujtojnë jo më pak se sa një trajner skuadre që di me kompetencë të organizojë një ekip të virtutshëm në fushën e lojës, së gatimit. Dhe Mukadesi është e veçantë në këtë gjë. Klevis Jalli, Ledio Daka, Mirjeta Driza, secili në punën e vet, ndjehen krenarë dhe komodë kur mbërijnë në fundin e realizimit të detyrave të tyre në përgatitjen e pjatës që kanë marrë përsipër.

Recepsionistët.

Lëmë orën e kuzhinës dhe në një mjedis tjetër gjejmë të mbledhur një grup tjetër nxënësish të veshur me redingota jelekë dhe pajon profesionalë të recepsionistit.

Fjorentina Kushta na shoqëron në brendësi të sallës ku mësohet për ushtrimin në “paskuinte” të të gjitha të dhënave që duhet dhe kalon një klient i mundshëm akomodues në hotelin e tyre të ardhshëm.

Këtu në këtë mjedis, si rregull kalojnë të gjitha të dhënat e personit që akomodohet dhe një sërë njerëzish angazhohen që klienti të ndjejë përkujdesjen e tyre orë e çast, që nga shoqërimi për në dhomë a suitë dhe deri tek detaje më të vogla të gardërobës etj.

Në përpiqemi që të mësojmë më shumë rreth këtyre nxënësve dhe qëllimit të orës së tyre mësimore dhe i grishim që të ulen e të na tregojnë.

Por... askush nuk dëshiron të ulet... mos është ndonjë truk e trill, -mendojnë së pari, por në të vërtetë ata e kanë në edukatën e punës së tyre se një recepsionist është gjithmonë në këmbë. Vetëm në këmbë në kuptimin më të plotë të kësaj fjale, për t’iu shërbyer klientëve të vet.

Arbër Osmani, Jorgena, e të tjerët gati të përsërisin në një zë. -Parimi ynë është ky: Klienti është mbret, dhe ne jemi shërbëtorët e tij për sa kohë ai gjen veten tek shërbimi ynë.

Bari

Na mbeten ndër mend fjalët e recepsionistëve të ardhshëm dhe ndjehemi mirë që një shkollë e tillë, ndër të vetmet dhe thujse e papërsëritshme në mbarë vendin, me një drejtim e synim të tillë profesional, udhëhiqet nga filozofi të tilla kaq moderne siç është ai i shërbimit dhe përkujdesjes ndaj klientit, Kalojmë në një mjedis tjetër që ata e quajnë Bar Restorant. Edhe kjo është një klasë e vogël e adaptuar si e tillë.

Në të vërtetë, thotë drejtore Flutura, këtë lëndë të specifikuar e ushtrojnë përgjithësisht vitet e treta. Dhe në Bar shërben vetëm një nxënës i tillë, dy të tjerët, një vajzë dhe një djalë janë në klasën e dhjetë dhe duket tek ta brishtësia dhe emocionet e fillestarëve në shërbimin e barit. Por teksa mësojnë qëllimin tonë bëhen edhe më të shkathët.

Nga këtu kalojmë thujse në të gjitha mjediset e katit të dytë dhe të tretë të shkollës “Hoteleri Turizëm”. E njëjta frymë dhe atmosferë, i njëjti angazhim dhe përkushtim i nxënësve dhe gjithkund metoda të reja dhe moderne mësimdhënieje. Teksa bëhemi të largohemi nga mjediset e brendshme, drejtuesit e saj nuk kanë se si të mos të bëjnë me shenjë nga ish ndërtesa e shkollës, që shërbente si konvikt i nxënësve në vitet të shkuara dhe që në kohën e tranzicionit është pushtuar nga banorë të statusit jetim.

-Na prishin kësioj fort punë shkollës dhe nxënësve.

Ja, nuk do nguceshim nëpër ato mjediset e ngushta të Barit, Kuzhinës etj, por do shpalosim një performancë krejt tjetër nëse do ishte e mundur që Bashkia t’i sistemonte këto familje diku gjetkë dhe të lironin mjediset e shkollës. - të thonë thujse të gjithë në këtë shkollë.

E kotë të pyesim më tej se sa përpjekje janë bërë nga drejtorja e mësuesit për të zgjidhur këtë ngërç. Na mbetet vetëm të shpresojmë që në zgjidhjen e drejtë dhe efektive dypalëshe të këtij problemi, ndaj dhe largohemi nga shkolla “Hoteleri Turizëm” me status kombëtar për të hyrë në një tjetër të tillë në kryeqytet.



Në shkollën teknike elektrike “Gjergj Canco”

Afër qendrës së kryeqytetit, në po atë ditë të ftohtë janari, na i ngrohu zemrat ambienti i këndshëm dhe mikpritës nga nxënësit dhe stafi pedagogjik i shkollës Teknike Elektrike “Gjergj Canco”, e cila ndodhet në rrugën “Xhorxhi Martini”. Hymë brenda ambienteve të shkollës duke kërkuar të takojmë së pari drejtoreshën e kësaj shkolle. Ngjismim shkallët në korridor në një qetësi absolute pasi në disa klasa zhvillohej mësim.

Drejtoresha e shkollës zonja Hedi Bejtja na ftoi të ulëshim. Zonja Bejtja na informoi mbi, synimi e kësaj shkolle: të ofrojë një edukim të plotë, të përgatisë persona me integritet në një mjedis social aktiv.

“Nxënësit janë qëllimi ynë dhe do të jemi bashkudhëtarë në hedhjen e bazave të përgatitjes së tyre për jetën. Ne përpiqemi që kjo shkollë t’iu ofrojë mundësi formimi shumëdisiplinor nxënësve në mënyrë që ata të jenë të aftë të arrijnë objektivat e tyre profesionale për tu ofruar komuniteteve të tyre shërbim të specializuar.

Në bangat e saj, ulen çdo ditë rreth 600 nxënës dhe është pjesëmarrëse e konkursit kombëtar mbi sipërmarrjen rinore. Ky konkurs është pjesë e projektit “Skills for employability”, në të cilën marrin pjesë 41 shkolla profesionale në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu për rreth dy vjet shkolla ka lidhje biznese private dhe shtetërore, për punësimin e nxënësve, ku këta të fundit bëjnë praktika profesionale përveç atyre në laboratorët e shkollës.

Duke parë jo vetëm nga fjalët e drejtoreshës por edhe nga vetë ambienti, shihet qartë se kjo shkollë i jep prioritet orientimit nga praktikata, në mënyrë që këta nxënës të mos kenë përvetësuar vetëm njohuritë teorike, por edhe ato praktike duke i bërë të aftë për punësim të shpejtë ose vetëpunësim. Është e qartë se pas përfundimit të shkollës së mesme ata mund të konkurrojnë të sigurt në çdo degë që dëshirojnë, sepse formimi i tyre i përgjithshëm është i njëjti me çdo nxënës. Që të marrin sa më mirë njohuritë e degës së zgjedhur dhe që të jenë sa më të përgatitur, për ta përdoren dy metoda mësimdhënieje, ajo teorike dhe ajo praktike. Pra bëhet një kombinim i lëndëve teorike në mënyrë, që nxënësit të kenë mundësi të marrin njohuritë bazë, të diskutojnë, të bëjnë pyetje, dhe të kenë mundësi të zbatojnë njohuritë e tyre dhe të fitojnë shprehitë praktike të nevojshme për profesionin.

Mësuesit dhe mësimdhënia

Por është e vetëdijshme që për thithjen e sa më mirë të këtyre dijeve ka të bëjë edhe stafi mësimdhënës. Për këtë është bërë kombinim i mësuesve të kualifikuar të lëndëve të përgjithshme me specialistë me përvojë për lëndët profesionale. Stafi mësimor i formimit profesional përbëhet nga inxhinierë me eksperiencë shumë vjeçare në mësimdhënien dhe fakti që vijnë nga sektorë të ndryshëm të industrisë, jep garanci për përgatitjen e specialistëve të aftë në të gjitha specialitetet që ofron shkolla.

Arsimi Teknik-Profesional në këtë shkollë zgjat 4 vjet dhe është i organizuar me 3 nivele: Përparësitë e struktura 2 + 1 + 1 janë të tilla si: Siguron dalje në tregun e punës pas çdo niveli; Siguron mundësi vazhdimësie kualifikimi dhe shkollimi të mëtejshëm. Përshtatshmëri dhe fleksibilitet me tregun

e punës dhe aktivitetet ekonomike publike dhe private Në përfundim të çdo niveli, nxënësit pajisen me certifikate aftësie profesionale dhe në përfundim të katër viteve pajisen me Certifikatë të aftësive profesionale dhe Dëftesë Pjekurie, që i lejon të ndjekin studimet në arsimin e Lartë.

Shkolla përgatit nxënës me njohuri të plota tekniko-profesionale. Përgatit specialistë të certifikuar në kompetenca përkatëse, sipas drejtimeve mësimore.

Pak histori

Shkolla Teknike Elektrike është krijuar në shtator të vitit 1983. Fillimisht shkolla vendoset në ambientet aty ku sot është vendosur kolegji Turk “Mehmet Akif” dhe qëndroi deri në vitin 1992, më pas zhvendoset në ambientet e mëparshme aty ku sot është shkolla “Harri Fultz”. Që nga vitin 2002 dhe aktualisht, shkolla vendoset në ambientet e rikonstruara të konviktit të shkollës Ekonomike, ku është sot. Shkollës mban emrin e Mësuesit të Popullit “Gjergj Canco”. Në fillimet e saj shkolla ka funksionuar si shkollë e mesme e sistemit 4 vjeçar dhe më pas 5 vjeçar. Që në fillimet e saj shkolla ka pasur dhe ka ruajtur degët: Elektrik i Përgjithshëm, Elektronik i Përgjithshëm dhe Telekom.

Sot shkolla Teknike Elektrike “Gjergj Canco” si shkollë me status kombëtar frekuentohet nga të gjitha rrethet e Shqipërisë dhe studiohet sipas strukturës së re arsimore në tri drejtime mësimore: Elektroteknike, Elektronike dhe Teknologji e informacionit dhe komunikimit (TIK)

Në laborator

Pas disa minutash së bashku me drejtoreshë Dijen vizitua një nga një çdo laborator të shkollës të cilat janë një mbështetje mjaft e madhe e metodave të mësimdhënies. Çdo degë kishte laboratorin e vet, laboratorin i informatikës, elektroteknikës, elektronikës dhe makinave elektrike të pajisur me kompjuterë, projektorë, video dhe lidhje interneti.

Gjithashtu shkolla vazhdon të pasurojë infrastrukturën laboratorike me pajisje bashkëkohore. Projekti “CARDS AFP” i financuar nga Bashkimi Evropian ka ofruar mbështetje me pajisje, trajnim mësuesish dhe zhvillim të kurrikulave. Ndërsa aktualisht sipas drejtoreshës, shkolla mbështetet nga projekti “Invent”.

Për t’iu ardhur në ndihmë nxënësve, të cilët vijnë nga rrethet të ndryshme, shkolla iu mundëson strehim në konvikt e saj. Për ta kujdeset gjithashtu edhe një staf i kualifikuar kujdestarësh mjekësh dhe punonjësish socialë.

Në fund të ditës

Koha kishte kaluar shumë shpejt dhe na duhej të largoheshim nga ambientet e shkollës teknike-elektrike “Gjergj Canco”, duke mbartur me vete një ditë plot me atmosferë rinore, një rini e aftë dhe e përkushtuar, e gatshme për ti shërbyer vendit në profesione kaq të domosdoshme dhe tashmë, në vitet e fundit edhe të përqasura me profesionet e Evropës moderne dhe më gjerë. Tek vështron oborrin e mbushur me nxënës që luanin volejball, apo organizojnë kohën e lirë të mbasdites, të shkon mendja vetiu tek baballarët dhe gjyshërit e tyre që u përballën me sa e sa vështirësi në ndërtimin e vendit në të shkuarën e largët, me mungesë mjetesh dhe teknologji të tilla siç mësojnë ata vetë në ditët e sotme dhe ndjehesh optimist. Optimist se e ardhmja e teknologjisë sonë tashmë kalon nga dyer e shkollës. Kjo është një garanci për integrim të suksesshëm të vendit drejt bashkimit Evropian dhe botës së qytetëruar.



Studimi i heroit, forca e tij në romanin “Skënderbeu” të Sabri Godos dhe në tragjedinë “Jul Cezari” të Shekspirit

Belul MAHMUTAJ - Mësues, Lushnjë

Në kurrikulat e reja mësimore, letërsia e thelluar ka peshën e saj specifike. Ajo zhvillohet në klasën e dhjetë në dy module me nga 36 orë secili. Temë qendrore e këtyre moduleve është “Studimi i heroit, forca e tij në romanin “Skënderbeu” të Sabri Godos dhe në tragjedinë “Jul Cezari” të Shekspirit.

Tema:

Analiza e krahasuar e figurës së Skënderbeut si prijës në letërsinë shqipe dhe arbëreshe të periudhës së Humanizmit dhe Rilindjes në raport me “Skënderbeu” e S. Godos. Njëpërmyjet këtij projekti, synohet të njihemi me trajtimin e figurës së Skënderbeut në letërsinë shqipe dhe arbëreshe të periudhës së Humanizmit dhe Rilindjes, duke bërë krahasimin me trajtimin që i bën S. Godo figurës së Skënderbeut në romanin e tij

Për qëllimin e mësipërm mendojmë:

1. Të njohim autorët dhe veprat në të cilat është trajtuar figura e Skënderbeut në letërsinë shqipe dhe arbëreshe.
2. Të mbledhim informacione rreth këtyre autorëve .
3. Të mbledhim informacione rreth interpretimit të këtyre veprave.
4. Të mbajmë shënime dhe të skedojmë të gjithë punën e kryer.
5. Të bëjmë renditjen e materialit të vjelë
6. Të bëjmë krahasimin midis veprave të këtyre autorëve dhe “Skënderbeut” të S. Godos

Objektivat:

- Të njihemi në mënyrë shteruese me veprat e autorëve shqiptarë të këtyre periudhave.
- Të përcaktojmë kontekstin historik dhe letrar në këto vepra.
- Të analizojmë figurën e Skënderbeut si prijës në këto vepra.
- Të evidentojmë veçori të stilit dhe të gjuhës në këto vepra.
- Të reflektojmë rreth mendimit kritik për këto vepra.
- Të krahasojmë figurën e Skënderbeut si prijës të këtyre veprave me romanin e S. Godos.

Përfutjesit e projektit: nxënësit, mësuesit, komuniteti dhe të interesuar të tjerë

Mjetet e nevojshme: vepra të au-

torëve, fotografi të autorëve, vepra në pikturë për Skënderbeun, shkrime kritike, CD e filmit, videoprojektor, laptop.

Veprimtaritë: Hulumtimi në bibliotekën e qytetit, kërkimi në internet, vlerësime të kritikës, intervistë me autorin S. Godo (nëse munden)

Shkrimi i lirë: Leximi në auditorë i projektit të kryer

Hapat që do të ndiqen:

Hapi i parë:

Ndarja e punëve sipas grupeve

Prezantohet para nxënësve tema e projektit dhe kërkohet prej tyre që të hulumtojnë dhe kërkohen në bibliotekën e qytetit për veprën e M. Barletit, De Radës, N. Frashërit F. Nolit dhe S. Godos, duke u ndarë në grupe.

Grupi i parë: për veprën e Barletit, duke u ndalur në: kohën, qëllimin që u shkrua, karakterin humanist të veprës, vendi saj në letërsinë Humaniste europiane, Figura e Skënderbeut dhe qëndresa e shqiptarëve, Barleti historian dhe Barleti shkrimtar

Grupi i dytë: Për ‘Historinë e Skënderbeut’ të N. Frashërit, duke u ndalur në kohën e qëllimit përse u shkrua,, trajtimin e figurës së Skënderbeut si prijës luftarak, shpirtëror, temën e qëndresës, raportin histori /letërsi

Grupi i tretë: “Skënderbeu i pafan” e De Radës, duke u ndalur në kohën e qëllimit që u shkrua, tiparet romantike të saj, figurën e Skënderbeut si prijës luftarak, politik, diplomatik, shpirtëror qëndresën e shqiptarëve, veçori të stilit të De Radës.

Grupi i katërt: Për “Historinë e Skënderbeut” të F. Nolit, duke u ndalur në tiparet idealiste dhe realiste të trajtimit të figurës së Skënderbeut, shtjellimin e temës së qëndresës së shqiptarëve, ndaj pushtuesit turk, raportet trill - histori në vepër, veçori të gjuhës e të stilit.

Të gjithë grupet krahasimin do ta bëjnë me veprën e S. Godos, duke u përqendruar në trajtimin e figurës së Skënderbeut, si prijës, diplomat, politikan, burrë shteti, qëndresën e shqiptarëve, raportet letërsi - histori, e vërteta dhe trillimi në vepër, veçori të stilit dhe gjuhës në roman.

Hapi i dytë:

Parapërgatitja për të realizuar punën me projekt

Tërhiqet mendimi për mundësinë e realizimit të temës sipas grupeve, këshilla për vjeljen dhe grumbullimin e materialit në skeda, këshillohen për punën që duhet të bëjnë me interpretimet e shkrimit kritike, sigurohemi për shpërndarjen e barabartë të ngarkesës, qartësimi i grupeve për t’iu përbajtur temës dhe kërkesave të saj, përqendrimi në çështjet prioritare të temës, metodat që duhet të përdorin për vjeljen e materialit, planifikohet koha e prezantimit të çdo grupi

Hapi i tretë:

Shkrimi i punës së kryer.

Në këtë fazë nxënësit të kenë parasysh:

Procesin e krijimit të veprës “Skënderbeu” të S. Godos, kohën dhe qëllimin që u shkruan veprat, rëndësinë e figurës së Skënderbeut gjatë Humanizmit dhe Rilindjes, qëndresën shqiptare kundër pushtuesit turk, raportet histori - letërsi, në vepër, veçori të stilit dhe gjuhës të përdorura nga Barleti, De Rada, Naimi, dhe S. Godo.

Hapi i katërt:

Zgjedhja e mjedisit për të paraqitur projektin: Për këtë qëllim zgjedhim salla të mëdha, përdorim posterat, përdorim foltoret dhe foninë

Hapi i pestë

Leximi i punës së kryer: Për këtë fazë të projektit është mirë që të përzgjidhen nxënës që lexojnë, duke pasur parasysh: Volumnin, tonin, ritmin dhe intonacionin e duhur të zërit, të mposhtin emocionet, të krijojnë një mjedis të ngrohtë me auditorin, përcjellja e mesazhit nëpërmjet të folurit, të jete i veshur bukur dhe serioz, të kujdeset për mënyrën e qëndrimit para auditorit, të tregojë seriozitet.

Hapi i gjashtë

Vlerësimi i punës së kryer:

Për këtë qëllim të kihet parasysh si janë realizuar:

Figura e prijësit Skënderbeu, si figurë frymëzuese për Humanizmin dhe Rilindjen, figura e Skënderbeut në letërsinë realiste shqipe, tema e qëndresës në vepra të autorëve shqiptarë dhe në romanin e S. Godos, lidhja histori - letërsi në vepra dhe romanin e Godos, prezantimi që u bëhet temave nga nxënësit e zgjedhur.

Në fund mund të bëhen edhe pyetje e të diskutohet për to.

Mësimdhënia post-moderne

Bota në të cilën nxënësit do të punojnë ka fusha të ndryshme të aktivitetit dhe kërkon kompetenca të larmishme për realitetet e reja. Kjo është mjaft e komplikuar dhe bazat e para asimilohen me ndihmën e mësuesve, çka e bën tepër të rëndësishëm rolin e tyre. Programet e reja të cilat synojnë integrim janë të ndërtruara me qëllim realizimin e disa objektivave. Ato duan të drejtojnë vëmendjen e nxënësve për të kuptuar tema dhe probleme të ndryshme të së sotmes dhe të së ardhmes. Në këtë mënyrë kërkohet që nxënësit të ndjekin një të mësuar të orientuar, me kërkesa të cilat e bëjnë atë kreativ, të përshtatshëm, të pavarur në mendimet e tij dhe që të jetë i zoti të zgjidhë probleme në një kontekst global. Ndjekja e këtyre programeve bashkëkohore do të mundë të bëjë përballjen e nxënësve me sfidat e së ardhmes, kjo është dhe arsyeja kryesore e nxitjes drejt përvetësimit të këtyre metodave efektive të mësimdhënies në shkollën tonë. Mësuesi duhet të përdorë një larmi metodash për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të nxënësve. Mësuesi duhet të njohë, por edhe të përshtasë strategjitë e mësimdhënies për t'ju përgjigjur nevojave të nxënësve në çdo klasë. Planet ju mundësojnë shkollave jo vetëm të jenë në hap me zhvillimet shkencore, teknike dhe teknologjike, arsimore, ekonomike shkencore industriale, por ato do të arrijnë suksese të avancuara në zhvillimin maksimal të mundshëm të fëmijëve, nxënësve, studentëve e talenteve të fushave të ndryshme, që ata t'u prijnë ndryshimeve zhvillimore dhe të nxisin zhvillimet dhe përparimet e përgjithshme e në veçanti në arsim. Shkolla duke planifikuar vetë dhe duke realizuar objektiva do të dalë nga gjendja konservuese, d.m.th. nuk do të qëndrojë në gjendje të çimentuar, por do të jetë lëvizëse, efektive, cilësore. Pra një rol mjaft të rëndësishëm e luan mësuesi prandaj duke bërë një krahasim ndërmjet mësimdhënies moderne dhe post-moderne, realizohet sensibilizimi përfudimtar i të gjithë kolektivit për pjesëmarrjen e tyre në këtë trajnim me interesa të shumfishta (të mësuesve, të nxënësve dhe prindërve). Pas kësaj, planifikohet trajnimi i mësuesve në të cilin realizohet përshkrimi i teknikave dhe metodave të ndryshme bashkëkohore të zhvillimit të strategjive të mësimdhënies e të nxënësve në klasë dhe arrijtjet në rast realizimi. Një ndër objektivat e metodave të mësimdhënies duhet të inkurajojnë nxënësit që të pyesin dhe të bëjnë lidhje me informacionin që marrin. Nxënësit mësojnë kur ata janë të inkurajuar dhe kuriozë rreth botës së tyre. Mësuesi, duhet ndërkohë, të ndihmojë nxënësit për të pyetur dhe për të kërkuar përgjigje sa më të ndryshme. Të nxënësve reflektiv tek nxënësit fillon atëherë kur ai fillon të pyesë. Nxënësit, është e nevojshme, të ndihmohen për të parë lidhjet dhe idetë që vijnë përmes dhe në fusha të ndryshme të programeve të tyre, ide që lidhen me familjen, shokët e tyre, komunitetin, mjedisin dhe shoqërinë. Gjithashtu është e rëndësishme që mësimdhënia t'i adresohet një hapësire të gjerë njohurish, shprehish dhe vlerash, me një ngarkesë të përshtatshme për nxënësit të niveleve të ndryshme. Të mësuarit e nxënësve ndërtohet duke u bazuar në njo-

Eksperiencat e të nxënësve që kontribuojnë në arrijtjet e rezultateve të kurrikulit bazë duhet të vendosen në një kontekst të larmishëm që të përfshijnë shtëpinë, shkollën, vendet e punës, dhe komunitetin. "Në jetojmë në një botë që ndryshon.", shkruan Fullan.



Lumturi KOPANI - Shkolla "Skënder Çaçi"

huritë, shprehitë dhe vlerat që ofron një kurrikul i caktuar. Mësuesit duhet, ndërkohë, të vazhdojnë të marrin dhe llogarisin llojshmërinë e njohurive bazë, aftësive dhe vlerave që fëmijët sjellin nga mjedise të ndryshme, në shkollë, rrjedhimisht nxënësi bëhet më aktiv me atë që përfaqëson. Mësuesi duhet gjithashtu të njohë vlerat sjelljet e nxënësve dhe t'i zhvillojë ato më tej duke i vendosur nxënësit në një mjedis konfidencial, ku ata të zhvillojnë dhe ndikojnë në mënyrë pozitive mbi njeri-tjetrin. Mësuesi duhet të njohë aftësi e prirje të veçanta dhe të inkurajojë nxënësit, të vlerësojnë pikëpamjet e njëri-tjetrit për tema të ndryshme. Ka nxënësit të ndryshëm, me aftësi të ndryshme të mësuarit, me interesa të ndryshme dhe më stile të ndryshme të nxënësve. Ndërkohë një klasë e orientuar, më në qendër nxënësin, i jep shumë hapësira mësuesit për të organizuar mësimdhënien në mësim grupe të vogla, në punë individuale, në aktivitete të tjera të larmishme, interesante, tërheqëse të cilat duhet të jenë pjesë e zhvillimit profesional të mësuesit. Eksperiencat e punës në grup janë nga më të suksesshmet, nxënësit përmes tyre kanë përfitime intelektuale dhe sociale. Në grupe të vogla, nxënësit duhet të reflektojnë aftësi dhe mundësi për të zhvilluar aftësitë e të nxënësve të tyre dhe aktivitetit të tyre. E gjithë mësimdhënia duhet të jetë e bazuar në një vështrim të jetës si një tërësi e integruar, në të cilën njerëzit, gjërat, ngjarjet, proceset dhe idetë janë në marrëdhënie të vazhdueshme midis tyre. Përdorimi i teknikave dhe strategjive të zhvillimit të mendimit kritik për lexim-shkrimin, janë një mundësi dhe pasuri e gjerë ku mund të mbështetet mësuesi. Puna me projekte dhe me tema është tepër interesante dhe ngacmuese për motivimin e nxënësve për të mësuar, pra nxënësit do të ishin më të motivuar drejt qëllimit të tyre. Mësimdhënia duhet të vendoset në kontekstin që lidh punën e shkollës me jetën e përditshme, sepse të mësuarit përfshin jo vetëm zhvillimin e njohurive, por edhe përdorimin e konteksteve të të kuptuarit, mësimdhënia duhet ta vendosë nxënësin në kontekstin real jetësor, ku ai të aplikojë dijet e tij në situata sfidash. Eksperiencat e të nxënësve që kontribuojnë në arrijtjet e rezultateve të kurrikulit bazë duhet të vendosen në një kontekst të larmishëm që të përfshijnë shtëpinë, shkollën, vendet e punës, dhe komunitetin. "Në jetojmë në një botë që ndryshon.", shkruan Fullan. Kjo është një botë në të cilën ndryshimi është një udhëtim ku pikëmbërritja është e panjohur, ku problemet janë miqtë tanë, ku kërkimi i ndihmës është shenjë e forcës, ku nismat e njëkohshme nga lart-poshtë dhe poshtë-lart përzihen me njëra-tjetrën, ku kolektiviteti dhe individualizmi bashkëjetojnë në një tension produktiv. Vetëm njerëzit që zotërojnë njohuritë dhe aftësitë për ndryshim mund të realizojnë një ndryshim të efektshëm. Pra, ndryshimi i vërtetë, qoftë ky i dëshiruar ose jo, përfaqëson një përvojë serioze vetjake dhe kolektive të suksesshme, ai mund të sjellë një ndjenjë zotërimi, arrijtjeje dhe zhvillimi profesional, që karakterizohet nga paqartësia dhe pasiguria dhe nëse ndryshimi është i efektshëm.

Në kërkim të shkollave të mira

Vjollca SPAHO

Shkollat e mira janë tema bisede që hasim çdo ditë, e cila u intereson e i sensibilizon qytetarët, mund të tërheqë biznesin e një komuniteti, madje të ngrejë vlerat e këtij komuniteti.

Shkollat e mira janë vende ku duan të punojnë shumë mësues dhe ku shumë prindër duan të dërgojnë fëmijët e tyre. Tingëllon si një çështje shumë e thjeshtë, por vetëm këto vitet e fundit, sa reforma janë bërë në arsim me qëllim përmirësimin e nivelit arsimor dhe shtimin e sa më shumë shkollave cilësore.

Kur një shkollë është e mirë ?

Ja si thotë një mësuese me përvojë: “ Në shkollë, mendoj , fokusi i arsimit duhet të jenë vetë nxënësit. Mësuesit e kësaj shkolle duhet të jenë këshilltarë të kualifikuar. Ata duhet të mësojnë si të dëgjojnë efektivisht dhe t’i drejtojnë nxënësit drejt objektivash personale. Burimet e shkollës duhen përdorur për të ndihmuar nxënësit të mësojnë rreth vetes dhe të gjejnë interesat e tyre. Kontrolli i përparimit të nxënësve duhet të jetë i shpeshtë dhe të afshohet në klasë”.

Kontrolli i përparimit të nxënësve

Kam dy provime nesër,- më thotë vajza e një shoqes sime, - pasi mbyllet semestri dhe mësuesit duan nota në regjistër. Nisur nga ky fakt mjaft i njohur edhe nga strukturat arsimore në qendër dhe bazë, m’u kujtua vizita në dy shkolla të qytetit tim për të cilat inspektorë të DAR-së më thanë që njëra po përparonte mirë, kurse tjetra jo aq mirë. Shkollat u shërbenin të njëjtëve komunitet dhe mësuesit kishin të njëjtat aftësi profesionale.

Atëherë, pse njëra ishte më efektive se tjetra në përparimin e nxënësve?

Ishte nëntor. Bëra një vizitë në shkollën e parë. Ndërsa ecja përmes korridoreve u befasova nga paraqitja tërheqëse e punimeve të nxënësve të vendosur në muret dhe këndet e klasës dhe të shkollës. Ishin afishuar , gjithashtu grafikë, që dokumentonin qartë përparimin e nxënësve për çdo javë. Intervista që bëra me nxënësit të ndryshëm treguan se ata kishin sens të qartë për ecurinë e mësimeve të tyre. Kur intervistova disa mësues, ata ishin shumë të njohur me arritjet dhe dobësitë individuale të nxënësve dhe kishin dokumente të plota të rezultateve të tyre, testimi si ato të Maturës Shtetërore dhe modele të detyrave të klasës, të punëve me shkrim, ese të nxënësve tej.

Nga vizita në shkollën tjetër, pashë disa ndryshime të dukshme. Këndet e klasave dhe muret ishin tërheqëse, por kishte shumë pak letra të nxënësve të afishuara dhe asnjë grafik të përparimit të tyre. Intervistat me nxënësit treguan se ata kishin një gjë të turbullt, të paqartë: si përparonin, ose rrugët e përmirësimit të rezultateve të tyre mësimore.

Disa nxënës shprehnin habi bile edhe zemërim për vlerësimet e tyre në regjistër.

Siç më tha një nxënës: - “Unë nuk mund ta besoj kur pashë notën 6 në regjistër në lëndën e kimisë. U trondita sepse po përgatitesha çdo ditë megjithëse nuk shkoj në asnjë kurs kimie”.

Mësuesit, gjithashtu dukeshin të paqartë për përparimin individual të nxënësve. Kur e pyeta një mësuese për më shumë informacion, ajo më dërgoi tek drejtori i shkollës duke më thënë se atij ia jepnin listën e përparimit të nxënësve.

Në fund të kësaj vizite i dhashë një mesazh inspektorit të dyja shkollave: “Një arsye shumë e vërtetë për ndryshimin në efektivitet e shkollave është se njëra shkollë kontrollon me kujdes përparimin e nxënësve dhe ia komunikon këtë informacion nxënësve dhe prindërve, ndërsa shkolla tjetër nuk e bën këtë”.

Shkollat efektive kontrollojnë me kujdes dhe vlerësojnë progresin e nxënësve, me qëllim që të vendosin, nëse janë të nevojshme ndryshimet në programe, plane dhe metodat e mësimdhënies. Ato kryesisht përdorin metodat e mëposhtme të vlerësimit:

- Provimet e rekomanduara nga DAR sipas modeleve të AVA. Provime të tilla bëhen në kohë të caktuar gjatë vitit shkollor dhe nuk lihen vetëm në fund të çdo semestri. Një shkollë rajoni mund të bëjë testimi nga specialistë të DAR/ ZA-ve me qëllim për të përcaktuar p.sh. që tekstet e reja janë më të arrirë se të kaluarat, apo se kjo reformë apo ky udhëzim është i nevojshëm nga nxënësit, ose jo etj.

- Provimet e rekomanduara nga drejtorja e shkollës, të cilat bëhen për të krahasuar klasat e shkollës si edhe mësuesit.

- Provimet nga mësuesit me pikësynim për të vlerësuar nëse një nxënës ka përvetësuar disa pjesë kryesore specifike të njohurive, se sa të bëhen krahasime me nxënësit tjerë. Këto testimi vlerësojnë çfarë kanë mësuar nxënësit aktualisht. Provimet e rekomanduara nga mësuesit mund të bëhen më shpesh sepse ato japin informacion të nevojshëm për të bërë modifikimet e duhura në program dhe në mësimdhënie. Ato të mos lihen javën e fundit të semestrit.

- Mbajtja e dokumentacionit është një mjet tjetër i rëndësishëm i të kontrolluarit të progresit të nxënësve. Përparimi i nxënësve, grafiku i përparimit të tyre, mendoj, javor duhet të afshohet në muret e klasës dhe t’u raportohet prindërve.

- Gjithashtu detyra e shtëpisë është një mjet kontrollues, kur ato korrigjohen rregullisht nga mësuesi dhe kur shoqërohen me shënime dhe udhëzime.

Kontrolli i përparimit të nxënësve është një nga treguesit e shumtë për të pasur shkolla të mira dhe unë u ndala vetëm këtu. Por studiuesit, specialistët e arsimit, prindërit kanë mendime të shumtë për përcaktimin e shprehjes ”shkollë e mirë”. Një specialist arsimit kishte listuar disa karakteristika të një shkolle të mirë, një prind mendonte për të tjera. E kështu studim pas studimi shumë studiues kanë arritur të gjejnë modele të përbashkëta të shkollave të mira, të cilin po e rendis më poshtë gjë që s’do të thotë që kjo është e vetmja.

1. Udhëheqje e fortë administrative
2. Objektiva të qarta mësimore
3. Një ambient i sigurt dhe i disiplinuar shkollor
4. Kontroll dhe vlerësim i shpeshtë i përparimit të nxënësve
5. Kërkesa të larta ndaj përparimit të nxënësve.

Secili mund të shpreh mendimin e tij për karakteristikat që duhet të ketë një shkollë e mirë dhe t’i sjellë në revistën tonë”Mësuesi” me qëllim që lista e shkollave të mira të jetë sa më e gjatë.



Pyetje të shumta ngarkojnë ditën tonë, shumicës prej të cilave ne rrekemi t'u japim përgjigje. Një pjesë të përgjigjeve edhe i marrim. Për një pjesë tjetër marrim përgjigje të pjesshme dhe për një pjesë tjetër, të cilat nuk varen plotësisht nga ne edhe nuk mundim të marrim përgjigje.

Kështu, në rrethana të ndryshme ne pyesim veten pse fëmija im u soll në këtë mënyrë, pse reagoi ashtu, pse u zemërua etj. Ajo që ne nuk marrim sistematikisht në konsideratë është mosha dhe roli shoqëror i gjithsecilit. Pra, e faktit se midis nesh ka gjithmonë të mëdhenj dhe të vegjël.

Nisur nga kjo po sjell para jush dy situata, të cilat nuk shtrohen për diskutim apo për të dhënë përgjigje, por sjellin dëshmi të faktit pse disa pyetje brenda nesh nuk gjejnë përgjigje. Dhe nga ana tjetër, shpjegojnë ekzistencën e mjaft mosmarrëveshjeve prind-fëmijë, apo nxënës-mësues.

Në njërën prej situatave, mësuesja takon rastësisht prindin e vajzës x, së bashku me vajzën dhe ajo (prindi) i bën pyetjen rutinë mësueses: Si e kam vajzën? Mësuesja e nis me pyetjen nëse e kishte parë testin e fundit ku ajo kishte lënë edhe një shënim për prindin. Prindi thotë jo dhe vajza ndërhyr duke thënë; nuk ia kam dhënë akoma, duke shtuar; kam harruar. Prindi natyrisht që rebelohet dhe reagon në sy të mësueses duke e fyer pakës për këtë harresë të papritur që sipas mësueses nuk mund të ishte e para...

Në situatën tjetër, prindi, në një ambient kolektiv, "nxiton" të lëvdojë fëmijën e vet, duke vënë në dukje tipare dhe veprime që e kishin bërë atë të ndihej krenar për fëmijën e tij, por kjo gjë nuk i pëlqeu djalit 12 vjeçar Y. Natyrisht, pas kësaj, ai reagoi me një zemëratë dhe shmangie të vetes nga biseda dhe, pak më vonë, shmangie nga mbasditja me prindin.

Çfarë jemi duke thënë?

Në të dyja situatat kemi një element të përbashkët: Të gjesh momentin e duhur dhe mënyrën e duhur.

Në situatën e parë nuk kemi një moment të duhur. Edhe në pyetjen më të thjeshtë, apo në komunikimin më formal, ne duhet të kemi parasysh pritshmërinë, sidomos ato me natyrë psikologjike. Nëse ne, thjesht, do kishim një përshëndetje formale dhe një kon-

nuk njihet ndoshta për atë lloj kontributi, ose e ka fshehur atë tipar të tijin. Kështu, në raste të tilla, ne duhet të mjaftohemi me shprehje më të përgjithshme, të tilla si: jam e kënaqur, e gjitha kjo më duket mjaft mirë, apo kohët e fundit ne të gjithë kemi bërë këtë gjë dhe djali im Y ka marrë pjesë së bashku me ne... etj, etj.

Momenti i duhur dhe mënyra e duhur i adresohen sa mësuesit edhe prindit dhe kanë vlerë të veçantë për moshat deri në



statim të natyrës, vajza më ka folur për ju... etj etj, do t'i linim kohë vetes për të kuptuar çdo gjë. Dhe më pas, nuk do të kishim një përballje me një të vërtetë që në këtë rast lëndon fëmijën, fyen prindin dhe vë në siklet mësuesen.

Në situatën e dytë kemi mënyrën e gabuar, ku konstatimi i prindit në formën e lëvdatës, vë në siklet fëmijën, i cili në atë lloj auditori



shkollën e mesme, sidomos në periudha kalimtare moshore, ku fëmijët fillojnë dhe ndryshojnë rrënjësisht. Kjo është e lidhur me një predispozitë të veçantë që ata kanë në marrëdhënie me objektet dhe subjektet që i rrethojnë. Nevoja për pavarësi dhe nevoja për t'u ndjerë të sigurt, nevoja për krenari dhe nevoja për vetëterheqje i bën ata të ndihen jo mirë në situata, si dy të mësipërmet. Madje, nga shembuj të praktikës, është treguar që ata lëndohen më shumë nga prindi i tyre me arsyen e thjeshtë se ajo afron dashurinë më të madhe, por edhe sepse aty është mundësia më e madhe për reagim.

Durimi që ne shpesh ua mësojmë të tjerëve si pjesë personaliteti, duhet të na karakterizojë së pari si prindër dhe si mësues. Për të thënë dhe për të bërë gjërat që duam, ka gjithmonë kohë dhe vend.

Me kujtimet e shkollës “Kosova” në prag të 7 Marsit

Nga Emine OKTROVA

Me punën e shkollës “Kosova” dhe të drejtoreshës së saj, “Mësueses së merituar” Andromahi Noçka, jam njohur në fillim të karrierës time pedagogjike, vite më parë.

Kjo shkollë e ciklit të ulët ishte ushtrimore për nxënëset e Shkollës Pedagogjike të Tiranës, që kryenin praktikën pedagogjike aty. Unë kam qenë një nga drejtueset e kësaj praktike. Për rezultatet e saj, kjo shkollë renditej ndër më të mirat e vendit. Për këtë dhe drejtoresha respektohej si mësuese e aftë dhe e përkushtuar në punë dhe si drejtuese, që dinte të ndërtonte marrëdhënie, sa mobilizuese për punën, aq edhe humane me koleget e saj. Drejtoresha ishte e ndjeshme jo vetëm për rezultatet e punës së tyre mësimore, por edhe ndaj jetës së tyre private, ndaj halleve familjare.

Ndryshe nga mësueset e shkollave të tjera, drejtoresha dhe nxënëset e kësaj shkolle, përveç punës mësimore me klasën, ishin dhe metodiste që, sipas kërkesave të mësueseve të pedagogjisë praktike dhe metodisteve të gjuhës dhe matematikës (të shkollës pedagogjike), përgatishnin dhe zhvillonin mësimet të hapura për nxënëset e pedagogjikes, i udhëzonin kandidatet e reja (për mësuese) për të hartuar plankospektet e mësimave-prova, merrnin pjesë në zhvillimin e mësimin prej tyre, po ashtu në orët e analizave të drejtuara nga mësueset e pedagogjisë praktike dhe metodistët.

Me gjithë këtë ngarkesë dyfishe, puna në shkollë shkonte si sahat. Dhe shpirti i gjithë këtij rregulli ishte drejtoresha, e cila njëkohësisht ishte dhe mësuese e klasës së dytë. Ajo ndiqte sistematikisht si procesin mësimor të shkollës, ashtu edhe punën me kandidatët për mësuese.

Të qenët shkollë model për mësueset e ardhshme kërkonte punë kualifikuese, për të qenë në pararojë të zbatimit të metodave të përparuar të mësimdhënies dhe edukimit. Studimi dhe diskutimi në këshillin pedagogjik i literaturës profesionale përbënte thelbin e suksesit të shkollës. Drejtoresha ishte e para që e bënte këtë në mënyrë të thelluar. Rezultati i kësaj përgatitjeje teorike, gjithnjë të përditësuar, dukej në nivelin e lartë shkencor dhe metodik të mësimave dhe veprimtarive edukative. Dhe në zbatimin praktik të teorisë drejtoresha ishte gjithnjë shembull i mirë për të gjitha koleget e saj. Ajo ishte gjithnjë në aktivitet mes mësueseve dhe nxënësve, të cilët i njihnte të gjithë, pa përjashtim. Me vite kjo drejtoreshë luftoi për krijimin e traditave të bukura në jetën e shkollës. Traditat, dihet që janë mënyra veprimi që, duke u zbatuar vazhdimisht përsosjen dhe kthehen në nevojë jetësore, domosdoshmëri për njeriun. Ato kryhen pa vështirësi nga brezi në brez dhe askujt nuk i shkon ndërmend t’i ndryshojë.

Disa nga traditat e kësaj shkolle që më kanë mbetur të paharruara po i rendis më poshtë.

- Shkolla shquhej për një disiplinë, e cila nuk mbahej nga frika, por nga të kuptuarit të rëndësisë së rregullit. Mbresa më e bukur që më ka mbetur nga rregulli ishte përpikmëria

në oraret. Fillimi i mësimin gjithnjë i gjente në klasë mësueset, nxënësit, kandidatet dhe drejtueset e pedagogjisë praktike. Ora e parë fillonte sekondë më sekondë në orën tetë. Kur mendon se ishin rreth tetëdhjetë veta, që merrnin pjesë në çdo klasë, e kupton mrekullinë e kësaj tradite. Kështu vazhdonte në të gjitha orët që pasonin dhe në veprimtaritë edukative, çdo ditë. Askush nuk e vinte në diskutim këtë rregull, atë e pranoni pa mëdyshje dhe prindërit. Ora e mësimin respektohej nga të gjithë. Dera e klasës nuk hapej nga askush dhe për asnjë arsye. Në korridoret dhe oborrin e zbrazur mbretëronte qetësia, punëtorët kryenin punët e tyre pa u ndjerë. Në pushimet midis orëve nuk kishte ecejake të panevojshme nxënësish dhe mësuesesh nëpër korridore.

Në pushimin e madh të gjithë nxënësit dilnin në oborr për të thithur ajër të pastër dhe për të luajtur lirshëm, duke shprehur dhe entuziazëm e thirrje të gëzuara. Dhe mësueset ishin në oborr, ku shpesh merrnin pjesë në lojëra me ta ose ishin në klasë me kandidatet për t’i ndihmuar në përgatitjen për mësimin pasardhës. Në atë shkollë nuk dëgjoje britma, të folur me zë të lartë, përplasje vizoreje në tavolinë për të mbajtur qetësinë, nuk shihje fytyra të tendosura.

Nuk bëhej fjalë për përdorim dhune fizike o psikike. Tradita e kësaj disiplinë në jetën e shkollës mundësonte një veprimtari të shëndoshë psikike të nxënësve, larg stresseve të panevojshme, pa cenuar zhvillimin normal të personalitetit të tyre.

- Kërkesa të pashkruara që ishin përpunuar në vite ishin edhe ato që kishin të bënin me paraqitjen e jashtme, duke filluar nga drejtoresha, mësueset, kandidatet, nxënësit e duke mbaruar me mjediset shkollore.

Mësueset kishin gjithnjë veshje e tualet të matur, po ashtu edhe një sjellje me nxënësit dhe prindërit që ishte shembull shumë i vyer jo vetëm për nxënësit, por edhe për kandidatet. Në këtë mjedis dhe nxënësit nuk mund të ishin ndryshe. Ta kishte ënda

t’i shikoje, të pastër e me një sjellje si të gjithë të rriturit që i rrethonin. Që në klasën e parë fitonin zakonin e të drejtuarit me mirësjellje dikujt: Me qëndrim gatitu, me duart jashtë xhepave dhe me të folur në numrin shumë. Dhe mjedisi shkollor ndrinte nga pastërtia. Asgjë nuk hidhej përtokë. Orenditë mirëmbaheshin, nuk kishte zhgarravina në banka e mure. Mjetet mësimore të ekspozuara në klasa ishin të paraqitura bukur, pastroheshin nga pluhurat dhe përditësoheshin sipas kërkesave didaktike të temave, që zhvilloheshin, pa i shkaktuar mbingarkesë perceptimit.

- Traditë tjetër e kësaj shkolle ishte koncepti për dhuratat.

Dhurata më e madhe që pranonin mësueset dhe drejtoresha ishte ndonjë degë mimoze, ose lule për 7 Marsin dhe në ditën e parë të shkollës, jo dhurata të shtrenjta, jo pagesa suplementare nga prindërit për konsultimet jashtë mësimin. Këto të fundit zhvilloheshin rregullisht, sipas një orari që shkolla të kishte përparim të lartë, pra quheshin pjesë e detyrës, nuk merreshin kurrë si mbingarkesë.

- Tradita më thelbësore, sidomos për natyrën e kësaj shkolle,



Në linje me vizionin për të përmbushur misionin

National Team of Trainers (NTT) ose Skuadra Kombëtare e Trajnuesve (SKT) u krijua në vitin 2005, si initiative e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe Këshillit Britanik, për krijimin e një grupi trajnuesish profesionistë për gjuhën angleze në nivel kombëtar.

SKT është një ekip trajnerësh, të certifikuar si trajnerë të mësuesve nga institucioni i mirënjohur Britanik "BELL College", i specializuar në përgatitjen e trajnuesve të gjuhës angleze, mbështet zbatimin në praktikë dhe trajnojnë mësuesit e gjuhës angleze në linjë me politikat e MASH, dokumentet dhe materialet e përgatitura për ngritjen në nivel bashkëkohor mësimdhënies/nxënies së gjuhës angleze. Përzgjedhja e ekipit u bë nga ekspertë të këtij institucioni, ndërsa trajnimi u realizua me video konferenca, forume on-line, trajnim i drejtpërdrejtë nga dy specialistë të fushës, Z. Jim Scrivener dhe Znj. Silvana Richardson. **Synimet e SKT janë:** Të ndihmojë mësuesit e gjuhës angleze për ngritjen e tyre profesionale; të përditësojë nevojat e tyre me të rejat në fushën e mësimdhënies/nxënies së gjuhës angleze; të mbështesë IZHA dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale në zbatimin dhe realizimin e politikave arsimore për zbatimin e kurikulave bashkëkohore; të bashkëpunojë me MASH, Universitetin dhe partnerë të huaj për zbatimin e iniciativave të ndryshme në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve të gjuhës angleze në vend. Angazhimi i parë institucional i SKT është zbatimi në praktikë i Projektit "Global English Product", projekt me tre faza dhe shtrirje 4 vjeçare. Ky projekt po zbatohet në bashkëpunim me Këshillin Britanik, MASH, IZHA dhe ELTA. Faza e parë e projektit u realizua me mbështetjen e Këshillit Britanik. Ky bashkëpunim kishte për qëllim të promovonte SKT, si një organizëm trajnues për programe ambicioze në fushën e mësimdhënies/nxënies dhe të familjarizonte sa më shumë aktorë nga fusha e arsimit në lidhje përdorimin falas të dy faqeve të interneti të ofruara nga Këshilli Britanik:

www.teachingEnglish.britishcouncil

www.learnEnglish.Britishcouncil

Aktualisht, SKT po zbaton fazën e dytë të GEP, në bashkëpunim me MASH, IZHA dhe Këshillin Britanik me fokus të përcaktuar; të trajnojnë mësuesit dhe nxënësit e arsimit parauniversitar për përdorim të dy faqeve elektronike. Objektivi i fazës së dytë është trajnimi dhe regjistrimi në këtë faqe interneti i 12 DAR-ve, 800 mësuesve dhe 1500 nxënësve nga e gjithë Shqipëria. Realizimi me sukses i kësaj faze do të çojë në zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të mësuesve dhe nxënësve që përdorin internetin dhe teknologjinë bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, duke e parë këtë si një nga përparësitë e MASH dhe të Qeverisë Shqiptare. Partnerët po luajnë rolin e tyre në realizimin me sukses të projektit. Kështu, IZHA ofron përvijë, këshillim si dhe mbështetje për trajnimin e mësuesve në zbatimin e projektit nga pikëpamja e kurrikulave. Rol të rëndësishëm kanë Drejtorinë Arsimore Rajonale, të cilat do të drejtojnë grupin rajonal i përbërë nga DAR, SKT, shkollat dhe ELTA, do të planifikojnë shkollat dhe mësuesit pjesëmarrjes në projekt për qarqet respektive duke siguruar pjesëmarrjen e shkollave të përzgjedhura për zhvillimin e veprimtarive trajnuese në shkollat dhe mjedise shkollare të pajisura me internet.

Cilat janë përfitimet për mësuesin dhe nxënësin në këtë projekt?

Mundësia për mësuesit për të pasur materiale on-line falas dhe për t'i përdorur në orët e tyre të mësimin, për një bashkëpunim më të afërt me rrjete pune të mësuesve të gjuhës angleze në mbarë botën, zhvillim profesional të mësuesve, duke përfshirë përmirësimin e përdorimit të anglishtes së tyre, projektimin dhe zhvillimin e materialeve të reja për orën e mësimin, përgatitja e aftësive të nxënësve për tregun e punës, mundësi për nxënësit për të krahasuar nivelin e tyre të njohurive me nivelet evropiane. *Kontakti me adresën: sbdautaj@yahoo.com*

N J O F T I M

Bursa studimi universitare ose pasuniversitare në Malajzi për vitin akademik 2011-2012

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Teknik me Malajzinë (MTCP), qeveria malajziane ofron për shtetasit shqiptarë 2 (dy) bursa për studime universitare ose pasuniversitare në fushat teknike, për vitin akademik 2011-2012. Bursat e studimit të ofruara nga pala malajziane mundësojnë studime të avancuara akademike në Malajzi dhe vënie në zbatim të njohurive të fituara në vendet e tyre pas përfundimit të këtyre studimeve. Bursa për studime pasuniversitare në ciklin e studimeve Master zgjat 12-14 muaj dhe për ciklin e studimeve në Doktoraturë (PhD) zgjat 36 muaj. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga pala malajziane. Aplikantët e interesuar për këto bursa studimi duhet të paraqesin në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dokumentet e mëposhtme:

Për studime universitare:

1. Dëftesën e shkollës së mesme, ose vërtetimin e notave të tre viteve të para dhe të semestrit të parë të vitit të katërt të shkollës së mesme. Këto dokumente duhet të jenë të firmosura nga Drejtoria Arsimore e Qarkut, ose nga Zyra Arsimore e rrethit përkatës;
2. Kërkesën për studime, ku të specifikohen dega në të cilat aplikanti dëshiron të studiojë;
3. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
4. Certifikatën e lindjes ose një fotokopje të kartës së identitetit;
5. 2 fotografi.

Për studime pasuniversitare:

1. Kërkesën e të interesuarit drejtuar MASH-it, duke specifikuar fushën e studimit në të cilën dëshiron të studiojë;
2. Fotokopje e noterizuar e Diplomës së shkollës së lartë;
3. Listën e notave, fotokopjen e noterizuar;
4. Dy letra reference nga profesorë të universitetit;
5. Programin e studimit;
6. Letra e pranimit nga Universiteti, në të cilin aplikanti dëshiron të studiojë;
7. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
8. Certifikatën e lindjes ose kopjen e kartës së identitetit;
9. 2 fotografi.

Kandidatët për studime pasuniversitare duhet të mos e kalojnë moshën 45 vjeç dhe të kenë njohje shumë të mirë të gjuhës angleze (kandidati duhet të jetë i pajisur me certifikatën e TOEFL-it ose të IELTS-it). Nëse do të jetë e nevojshme, aplikantët do t'i nënshtrohen intervistës me gojë ose testimit të gjuhës angleze që përgatitet nga Ministria e Arsimit të Lartë të Malajzisë ose nga Bordi i Pranimeve pranë universitetit përkatës. Dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, brenda datës 15 mars 2011. Për një informacion më të detajuar lidhur me mënyrën e plotësimit të formularit të aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, lutemi referojuni adresave të mëposhtme:

<http://www.mohe.gov.my>
<http://mtcp.kin.gov.my>
<http://www.mtcp.epu.jp.m.my>

SEKTORI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

UDHËZUES

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1 PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2011

I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. Formulari A1 plotësohet për t'u regjistruar në Maturën Shtetërore 2011 nga maturantët e vitit shkollor 2010-2011 dhe maturantët e viteve parardhëse që nuk kanë marrë dëftesë pjekurie.
2. Formulari A1 plotësohet me stilolaps me një ngjyrë, blu ose të zezë dhe me shkronja të mëdha.
3. Formulari A1 konsiderohet i vlefshëm VETËM nëse është plotësuar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.
4. Formulari A1 dorëzohet në Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore (KSHMSH), ku maturanti ka vazhduar/vazhdon shkollën. Në çdo rast tjetër ky formular dorëzohet në (KSHMSH) e përcaktuar nga DAR/ZA-ja.
5. Shpërndarja, plotësimi dhe dorëzimi i Formularit A1 fillon më datë 20 shkurt 2011 dhe përfundon më datë 10 mars 2011.
6. Në rast se maturanti ka bërë gabime në plotësimin e formularit, ai mund të plotësojë një formular tjetër A1, i cili zëvendëson të parin. Zëvendësimi i formularëve mund të pranohet nga Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH) vetëm brenda afatit të dorëzimit të tij (10 mars 2011).
7. Formulari A1, pas plotësimit, kontrollohet me kujdes për saktësinë dhe më pas firmoset nga maturanti, mësuesi kujdestar/anëtari i KSHMSH (për rastet kur maturanti është para vitit 2011) dhe drejtori i shkollës.

8. Çdo formular vuloset me vulën e shkollës.

II. UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT

Në hapësirat e lëna bosh tek Formulari A1, plotësoni:

1. Emrin e DAR ose ZA, ku jepni provimet;
2. Emrin e qytetit ose fshatit, në të cilin ndodhet shkolla juaj;
3. Emrin e shkollës ku keni studiuar/po studioni;
4. Bazuar në tabelën Nr.1 (Indekset e profileve/degëve), gjeni indeksin e degës dhe shënoni numrin që përfaqëson dega që keni ndjekur/po ndiqni, p.sh.: Gjinnazi-Drejtimi Shoqëror, në tabelë ka indeksin 2, kështu që në formular ju do shënoni numrin 2. (Plotësohet nga mësuesi kujdestar/anëtari i KSHMSH).
5. Emrin, Atësinë, Mbiemrin

Kujdes! - të dhënat e mësipërme i plotësoni me shkronja të mëdha dhe në përputhje me dokumentin e identifikimit.

- bëni kujdes me shkronjat (Ë) dhe (Ç).
- 6. Shënoni datëlindjen tuaj, duke plotësuar me dy shifra ditën dhe muajin, (p.sh.: 05/12/1992).
- 7. Vendosi shenjën X në kutinë që i përket gjinisë suaj. P.sh.: nëse i përkisni gjinisë femërore shënoni X në kutinë përmbri fjalës "Femër".
- 8. Vendosi shenjën X në kutinë Po, nëse do të vazhdoni studimet jashtë shtetit, ose në kutinë Jo, nëse nuk do të vazhdoni studimet jashtë shtetit.
- 9. Qarkoni IV ose V dhe shkronjat përkatëse A, B, C, D, E, F, G, H, I, K, L, M, N, O, P, Q, R, S. (P.sh.: nëse jeni në klasën IV B qarkohet IV dhe shkronja B dhe, nëse jeni në klasën V D, qarkohet V dhe shkronja D). Në rastin kur shkolla ka përdorur numra për emërtimin e klasave, mësuesi kujdestar/anëtari i KSHMSH të konvertojë numrin në shkronjë, sipas radhës së përcaktuar më sipër.

10. Bazuar në listën e lëndëve me zgjedhje, qarkoni 2 lëndët me zgjedhje që do të jepni provim dhe numrat që u korrespondojnë atyre.

P.sh.: 6. NJOHURI PËR SHOQËRINË dhe 8. GJUHË ANGLEZE

Kujdes!

Mund të zgjidhni duke qarkuar vetëm njërën nga lëndët e pikave 8-12 (Gjuhë angleze, Gjuhë frënge, Gjuhë italiane, Gjuhë gjermane, Gjuhë spanjolle).

Vetëm maturantët e shkollave artistike dhe koreografike mund të zgjedhin duke qarkuar vetëm njërën nga lëndët e pikave 13-17 (Histori muzike, Harmoni, Histori arti, Anatomia, Histori baleti).

Shënim:

- Maturanti firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Mësuesi kujdestar/anëtari i KSHMSH shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja të mëdha) dhe firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Drejtori shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja të mëdha), firmos dhe vulos me vulën e shkollës në hapësirën e përcaktuar për të.
- Nje kopje e formularit A1 ruhet në shkollë dhe formularët origjinalë përcillen nga KSHMSH në DAR/ZA.

FORMULARI A1

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË
PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2011

1. DAR ose ZA: _____ (Plotësohet nga mësuesi kujdestar/anëtari i KSHMSH)

2. Emri i qytetit/fshatit: _____

3. Emri i Shkollës: _____ (Plotësohet nga mësuesi kujdestar/anëtari i KSHMSH)

4. Indeksi i profilit/degës: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____

5. Emri: _____

6. Datëlindja (dd/mm/vvvv): _____

7. Gjinia: Femër Mashkull

8. Do të aplikoni për studime jashtë shtetit? Po Jo

9. Klasa IV / V: (A, B, C, D, E, F, G, H, I, K, L, M, N, O, P, Q, R, S)

10. Lëndët me zgjedhje: (Të qarkohen dy lëndë bashku me numrat përkatës)

Kujdes! Lexoni më parë pikën 10 të udhëzuesit, për të plotësuar saktë rubrikën.

1. FIZIKË

2. KIMI

3. BIOLOGJI

4. HISTORI

5. GJEOGRAFI

6. NJOHURI PËR SHOQËRINË

7. EKONOMI, FILOZOFI

8. GJUHË ANGLEZE

9. GJUHË FRËNGE

10. GJUHË ITALIANE

11. GJUHË GJERMANE

12. GJUHË SPANJOLLE

13. HISTORI MUZIKE

14. HARMONI

15. HISTORI ARTI

16. ANATOMI

17. HISTORI BALETI

Firma e maturantit _____

Mësuesi kujdestar/Anëtari i KSHMSH _____

Drejtori i shkollës _____

VULA

UDHËZUES

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1Z PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE QË KANË PËRFUNDUAR SHKOLLËN E MESME PËRPARA VITIT 2011, NË PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2011

I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. Formulari A1Z plotësohet për t'u regjistruar në Maturën Shtetërore 2011 nga të gjithë kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme brenda dhe jashtë shtetit para vitit 2011 dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2011.
2. Formulari A1Z plotësohet me stilolaps me një ngjyrë blu ose të zezë dhe me shkronja të mëdha.
3. Formulari A1Z konsiderohet i vlefshëm VETËM nëse ai është i plotësuar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.
4. Formulari A1Z dorëzohet në Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore (KSHMSH) ku kandidati ka mbaruar shkollën. Në çdo rast tjetër ky formular dorëzohet në (KSHMSH) e përcaktuar nga DAR/ZA-ja.
5. Shpërndarja, plotësimi dhe dorëzimi i Formularit A1Z fillon më datë 20 shkurt 2011 dhe përfundon më datë 10 mars 2011. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, plotësojnë Formularin A1Z në periudhën 1-15 maj 2011.
6. Në rast se kandidati ka bërë gabime në plotësimin e Formularit A1Z ai mund të plotësojë një formular tjetër A1Z, i cili zëvendëson të parin. Zëvendësimi i formularëve mund të pranohet nga Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH) vetëm brenda afatit të dorëzimit të tij (10 mars 2011).
7. Formulari A1Z, pas plotësimit, kontrollohet me kujdes për saktësinë dhe më pas firmoset nga kandidati, anëtari i KSHMSH dhe drejtori i shkollës.
8. Çdo formular vuloset me vulën e shkollës.

II. UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT

- Në hapësirat e lëna bosh tek Formulari A1Z, plotësoni:
1. Emrin e DAR ose ZA, ku do të jepni provimet;
 2. Emrin e qytetit ose fshatit, në të cilin ndodhet shkolla;
 3. Emrin e shkollës ku keni studiuar;
 4. Bazuar në tabelën Nr.1 (Indekset e profileve/degëve) gjeni indeksin e degës dhe shënoni numrin që përfaqëson dega që ju keni ndjekur, p.sh.: Gjimnazi-Drejtimi Shoqëror, në tabelë ka indeksin 2, kështu që në formular ju do shënoni numrin 2. (Plotësohet nga anëtari i KSHMSH).
 5. ID që keni patur në Maturën Shtetërore 2006, 2007, 2008, 2009, 2010. Tek viti shënohet viti dhe tek ID shënohet numri që keni patur si ID në atë vit. Nëse jeni pajisur dy a më shumë herë me ID, shënohet viti i fundit dhe ID e vitit të fundit. Nëse kandidati regjistrohet për herë të parë në Maturën Shtetërore nuk e plotëson ID. (Plotësohet nga drejtori i shkollës).
 6. Emrin, Atësinë, Mbiemrin
- Kujdes!** Të dhënat e mësipërme i plotësoni me shkronja të mëdha dhe në përputhje me dokumentin e identifikimit.
- Bëni kujdes me shkronjat (Ë) dhe (Ç).
7. Shënoni datëlindjen tuaj, duke plotësuar me dy shifra ditën dhe muajin, (p.sh.: 05/12/1992).
 8. Vendosni shenjën X në kutinë që i përket gjinisë suaj. P.sh.: nëse i përkisni gjinisë femërore shënoni X

në kutinë përbri fjalës "Femër".

9. Shënoni vitin kur keni përfunduar studimet në shkollën e mesme, (p.sh....., 2008, 2009, 2010).

10. Vendosni shenjën X në kutinë Po, nëse do të vazhdoni studimet jashtë shtetit, ose në kutinë Jo, nëse nuk do të vazhdoni studimet jashtë shtetit.

11. Shënoni përkatësisht lëndët e detyruara dhe notën e shkalëzuar.

12. Lëndët me zgjedhje mund të rijepen, por dhe mund të mbarten njëra ose të dyja, sipas dëshirës së kandidatit.

1) Në hapësirat bosh shënohet emri i lëndës (lëndëve) me zgjedhje që do mbartet (mbarten) dhe viti kur është dhënë

INDEKSET E PROFILEVE / DEGEVE TE SHKOLLAVE TE MESME 2011

INDEKSET	SHKOLLAT E MESME, DEGËT
1	GJIMNAZI DREJTIMI NATYROR
2	GJIMNAZI DREJTIMI SHOQËROR
3	GJIMNAZI DREJTIMI I PËRGJITHSHËM
4	SH. M. P. E PAPROFILIZUAR (PARA 2007)
5	GJIMNAZI ME KOHË TË SHKURTUAR
6	NATYROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
7	SHOQËROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
8	SHOQËROR 2 GJUHËSH ITALIANE
9	GJUHË E HUAJ ANGLISHT
10	GJUHË E HUAJ FRËNGJISHT
11	GJUHË E HUAJ GJERMANISHT
12	GJUHË E HUAJ SPANJISHT-RUSISHT
13	GJUHË E HUAJ ITALISHT
14	ARTISTIKE KOREOGRAFI
15	ARTISTIKE ARTE FIGURATIVE
16	ARTISTIKE MUZIKË
17	SPORTIVE FUTBOLL
18	SPORTIVE ATLETIKË
19	SPORTIVE VOLEJBOLL
20	SPORTIVE BASKETBOLL
21	PEDAGOGJIKE 4 VJEÇARE
22	PEDAGOGJIKE GREQISHT GJIROKASTËR
23	TEKNIKE 5 VJEÇARE (BANKA/TATIME/SIGURIME)
24	TEKNIKE EKONOMIKE 5 VJEÇARE TURIZËM
25	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 FERMER
26	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 HOTELERI TURIZËM
27	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 MAKINERI BUJQËSORE
28	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE BYLMET MISH
29	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE PIJE KONSERVA
30	TEKNIKE 5 VJEÇARE VETERINARI
31	TEKNIKE 5 VJEÇARE AGRO BIZNES
32	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRIK I PËRGJITHSHËM
33	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRONIKË
34	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTROTEKNIKË
35	TEKNIKE 5 VJEÇARE MEKANIK I PËRGJITHSHËM
36	TEKNIKE 5 VJEÇARE POLIGRAFIK
37	TEKNIKE 5 VJEÇARE PYJE
38	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK GJEODET
39	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK NDËRTIMI
40	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNOLOGJI USHQIMORE
41	TEKNIKE 5 VJEÇARE TELEKOM
42	HARRY FULTZ MENAXHER AUTOMOBILASH
43	HARRY FULTZ BIZNES
44	HARRY FULTZ ELEKTRIKE
45	HARRY FULTZ ELEKTRONIKË
46	TEKNIKE 4 VJEÇARE (PARA 2007)
47	TEKNIKE PROFESIONALE ME KOHË TË SHKURTUAR
48	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 PERPUNIM DRURI
49	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 KONFEKSION-STILIM
50	PROFILI IM S'ËSHTË NË LISTË